

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7573 E premtë 29 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Dita e 26 qershorit ishte një ditë e rëndësishme për qeverinë shqiptare, për Shqipërinë dhe për popullin shqiptar në përgjithësi. Këtë ditë shqiptarët ...
Vijon në faqen 20

Nga REXHEP QOSJA

Hapja e dyerve të BE, vendim historik për Shqipërinë



Opinion **i** Ditës

Midis versionit të qeverisë që ka filluar të thërrasë fitore dhe atij të opozitës që po klith për dështim në hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE-në, ka ...
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI

Rama nuk arriti të hapë negociatat, por ia doli të shmangë turpërimin



Paketa fiskale, zbardhet relacioni
Ulja e tatimit të fitimit në 5%, ja bizneset e vogla që përfitojnë

Subjektet me të ardhura 8-14 milionë lekë nuk do paguajnë më 15%. Favorizohet edhe agroturizimi

ORNELA MANJANI

Ndryshimet e fundit që Këshilli i Ministrave ka ndërmarrë në paketën fiskale duke ulur tatimfitimin nga 15 në 5% për fermerët që bashkohen në kooperativa, për bizneset e agroturizimit e ulja e tatimfitimit për bizneset ...
Në faqen 9

ZBARDHEN DESHMITË E TE ARRESTUARVE PER PARATE TEK "TOYOTA" NE PORT "EJANI NGA BARI", SI NDRYSHOI ITINERARI I 3.4 MLN EUROVE

Gjykata e Durrësit lë 4 vetë në qeli, gruaja e shoferit shpërthen në vaj: Ne s'kemi bukë të hamë. Prokuroria: Ka dyshime se kanë kaluar para edhe 2 herë të tjera



(Në foto) Alban Mollaymeri, Agim Çeka, Edi Lika dhe Klevis Lika, dje gjatë masës së arrestit në gjykatën e Durrësit

Në faqen 6

SHERRI NE KUVEND

Basha: Vendi u zbraz nga Kim Jong Uni. Rama: O Zot, vëri kufi budallenjve

Në faqet 2-3

INTERVISTA NE VOA

Kryemadhi: Ka patur pasaktësi në raportet e ndërkombëtarëve

Në faqen 5

BESKIDA ALIAJ

Studimet në Itali, hapet faza e dytë e aplikimeve, flet ekspertja

Në faqen 12

RELACIONI

Qeveria e vlerëson tokën e Teatrit Kombëtar me 500 milionë lekë

Në faqen 17

UDHEZIMI



Vizat turistike në SHBA, ambasada: Vendimi bazohet tek intervista

Në faqen 11

Arrestohet 29-vjeçari, tentoi të prishë kamerat e sigurisë të një biznesi

Plagosja në Kinostudio, dyshimi: Pazare droge

Banorët: Dëgjuam debatin mes të rinjve. Sulm me armë ndaj 2 vëllezërve

Nga INA ALLKANJARI

Një luftë me armë zjarri ka tronditur mesnatën e së enjtes lagjen "Kinostudio" në kryeqytet. Një konflikt, i cili dyshohet të ketë nisur për shkak të prishjes së pazareve të drogës dhe luftës për territor mes dy grupeve rivale,



ka çuar deri në përdorimin e armëve. Si pasojë e përplasjes kanë mbetur të plagosur tre persona, konkretisht dy vëllezërit Rivelino Mumajesi dhe Juxhin Mumajesi, si dhe 28-vjeçari Ibrahim Durollari. Mësohet se shënjestra e sulmit kanë qenë ...
Në faqen 7

NEGOCIATAT DEBATI

Kreu i PD: Në Europë nuk shkohet me atlete e poture, largimi i Ramës nuk mjafton

Valentina Madani

Shtyrja me një vit e hapjes së negociatave për Shqipërinë provokoi dje në Kuvend një debat të ashpër mes pozitës dhe opozitës. Vendimin e Luksemburgut për negociatat me Shqipërinë e lexuan ndryshe edhe në parlament. Debatimi seancë plenare vijoi me akuzat e opozitës për dëshitim, ndërsa kryeministri foli për mesazhe urimi nga homologët e tij evropianë. Opozita bën faktore për vendimin e shtyrjes qeverinë, ndërsa mazhoranca e sheh vendimin e Bashkimit Evropian si një dritë jeshile për negociatat dhe periudhën deri në qershorin e vitit 2019 si fazë përgatitore e procesit. Opozita largimin e kryeministrit dhe të qeverisë e sheh si të vetmen zgjidhje për aspiratën evropiane të Shqipërinë, por kryeministri nuk ia kursen ironinë kundërshtarit të tij politik. Duke e quajtur "kryemashtrues" e "tradhtar", kreu i PD-së Lulzim Basha deklaroi se Rama "do iu shesë sapunin për djathë, hapjen e negociatave për moshapjen e negociatave, kriminelët për ministra, mjerimin e shëndetësorisë si përparim, arsimin në ditëm më të zeza si arritje speciale të rilindjes". Kryedemokrati shtoi se që të shkohet në Europë, duhet që Rama të largohet nga qeverisja. "Mundësia jonë e vetme është ta largojmë sa më parë, na pret një detyrë e madhe, nuk shkohet në Evropë si kloun me atlete e poture, duke vjedhur popullin me tabiate orientale dhe njëherë në muaj duke bredhur në kryeqytete e duke folur si evropian, se e dinë që ky është vetëm një despot oriental, largimi i tij nuk është zgjidhje, pa largimin e tij nuk ka zgjidhje, por na lypset përfaqëse evropiane, sjellje evropiane ndërtuar mbi të vërtetën, transparencën", tha z.Basha.

Basha: Shqipëria më e zbrazët me Kim Jong Un dhe teveqelët e tij

"Qeveria më e zeza në 30 vjet, shet sapunin për djathë"



Kreu i PD-së Lulzim Basha

LULZIM BASHA

"Mundësia jonë e vetme është ta largojmë Ramën. Na pret një detyrë e madhe, nuk shkohet në Evropë si kloun me atlete e poture, duke vjedhur popullin me tabiate orientale dhe njëherë në muaj duke bredhur në kryeqytete e duke folur si evropian, se e dinë që ky është vetëm një despot oriental, largimi i tij nuk është zgjidhje, pa largimin e tij nuk ka zgjidhje, por na lypset përfaqëse evropiane, sjellje evropiane ndërtuar mbi të vërtetën, transparencën", tha z.Basha.

Seanca e djeshme parlamentare



"Rama i nxjerr statutet si simitet nga furra"

Spaho: Me Ramën, negociatat hapen pas zgjedhjeve të 2021

Kreu i Grupit Parlamentar të PD-së, Edmond Spaho, renditi dje 6 kushtet që sipas tij qeveria shqiptare nuk i kishte plotësuar dhe për rrjedhojë hapja e negociatave me BE-në u shty për në qershor të vitit të ardhshëm. Spaho tha se me këtë kryeministër dhe qeveri, mundësia më e parë që vendit tonë t'i hapen negociatat është pas zgjedhjeve të vitit 2021. "Nga sa na ka njoftuar kryeministri ynë me statutet e tij, të cilat i nxjerr si simitet nga furra, ai ka fituar një betejë 72 orësh me dallgë dhe BE na paska hapur negociatat për anëtarësim. Pas shtyrjes së negociatave në dhjetor 2013 dhe "hapjes" me kushte të negociatave në qershor 2016, tani në qershor 2018, "shkëmbi i grantit" në buzë të Adriatikut,



fitoi një betejë tjetër duke iu "hapur" negociatat, ndoshta në qershor 2019", tha z.Spaho. Ai shtoi më tej: "Në harem in qeveritar shpërtheu shampanja, gëzimi derdhet lumë, valon dajrja dhe gërneta, ca të huaj thonë që kjo është fitorja më e madhe e arritur nga Rama që nga kanabizimi i vendit në 2016, kurse Ditziu falënderon Europën që negociatat nuk

mentuar në çdo aspekt. Është i vetmi kryeministër që nuk ka asnjë arritje të vetme sa i takon integritimit. Toyotat janë maja e ajsgbergut. Pushetarët vijnë garant për eurot e pista", theksoi z.Basha.

Akuzave të Ramës se po punojnë kundër Shqipërisë, Basha iu përgjigj: "Tradhtari i Shqipërisë nuk është ai që denoncon drogën, krimin dhe korrupsionin, por ai që solli drogën dhe krimin".

LUAN RAMA

"Nuk ka një datë për çeljen e negociatave e nëse rekomandimi ka një datë dhe thotë që në x qershor do të çelen negociatat unë jap dorëheqjen sot ose ta japë Rama nëse nuk është kështu" theksoi në Kuvend nënkryetari i LSI.

u hapën. Por cila është e vërteta? Në qershor 2016 Evropa na vuri 5 kushte dhe shpresonim që negociatat do të hapeshin pas një viti, pra në 2017. Sot në 2018 na kanë vënë 13 kushte dhe shpresojmë se ndoshta hapen në 2019-ën. Kemi humbur 3 vjet nga "hapja" e vitit 2016 dhe 6 vjet nga viti 2013 kur Rama me Rilindjen e tij erdhi në pushtet".

Kreu i opozitës Basha tha se kryeministri Rama prej kohësh ka tradhtuar, jo vetëm aspiratën e shqiptarëve për të qenë si gjithë Evropa, por edhe ekzistencën e vendit. "BE nuk do t'i hapë negociatat sa

Shehi: Ne s'jemi shtet për Europën. Jemi me lugë bosh

Deputeti demokrat Dashamir Shehi, nga foltorja e parlamentit u shpreh se edhe vitin tjetër nuk ka garanci për hapjen e negociatave. Sipas tij vendi është në ditë të zeza dhe dikush duhet të mbajë përgjegjësi për këtë. "Jemi me lugë bosh". "Por as vitin tjetër nuk kemi garanci. Evropa, falë situatave të vështira mund të mos ketë të njëjtën përcjellje me Ballkanin edhe ne mund të ndodhim në vështirësi. Kjo është ditë e keqe dhe dikush duhet të mbajë përgjegjësi për këtë punë dhe jo të na tregojnë kalendarin që unë nuk kuptova gjë, por vetëm vështirësinë që ka për dialog. Se këtij i shtuan dhe Evropën. Na kanë lënë përjashta, sepse nuk e meritojmë. Sepse ata nuk mund t'i gënjejsh: Kanë para drogën, korrupsionin, dhe gjykan që, ju shqiptarë të nderuar, 4-5 kushtet t'i bëjmë 13", deklaroi z.Shehi.



Salianji në Kuvend me "Toyota Yaris" e çanta me euro

Deputeti demokrat Ervin Salianji surprizoi dje në Kuvend kur mbërriti me një automjet "Toyota Yaris" dhe dy çanta letre të stampuara me euro. Simbolika lidhet me ngjarjen në portin e Durrësit ku u kapën 3.4 milionë euro kontrabandë në dy makina "Toyota Yaris". Edhe pse seanca plenare vjen fill pas vendimit të BE për shtyrjen e negociatave në qershor të 2019, jashtë debateve mes palëve nuk mbeti as kjo çështje. Madje kreu i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla, i akuzuar nga opozita si garant për transportin e parave, pati paralajmëruar surpriza për lidhje të kreut të PD-së Basha me këto para.

kohë që krimi, korrupsioni dhe droga janë të vetmet produkte të kësaj qeverie. Për sa kohë kryeministri është faktuar si protektor i drogës në këtë vend. Për sa kohë nuk ka zgjedhje të lira...". Qeveria

është peng i krimi, u shpreh Basha, ndaj ftoi qytetarët në atë që ai e quan bashkim kombëtar për largimin e Edi Ramës, i cili, tha ai, mban peng integritimin dhe të ardhmen e vendit.



Kryeministri ironizon opozitën: O zot, pse e le budallallëkun pa kufi?!

Rama: Do shkoj në Bruksel të filloj punën me KE, këta thonë jep dorëheqjen

"Qershori është hija që do vazhdojë t'ju ndjekë nga pas"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama ironizoi dje, gjatë fjalës së tij në Kuvend qëndrimin e opozitës, pas vendimit të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të BE-së për negociatat me Shqipërinë. Duke ngritur pyetjen se përse duhet debatuar pas këtij vendimi, Rama përmendi një thënie të Konrad Adenauer, i cili ka thënë: "duke u nisur nga fakti që Zoti e kufizoi inteligjencën e njeriut, është vërtet e përdershme që nuk kufizoi edhe budallallëkun". "A ka njeri të ma thotë çfarë mund të debatohet në këtu me këta? Të debatohet pse Shqipëria ka këtë opozitë, që është e vetmja në historinë e procesit të integritimit në Bashkimin Europian që punon ditë-natë kundër vendit të vet, sa herë hap gojën dhe artikulon fjalë në gjuhë të huaja?! Dhe nuk e them unë këtë. Nuk e themi ne. Këtë e thonë tërë miqtë e Shqipërisë që ne takojmë. Këtë e thonë tërë ata që u angazhuan për Shqipërinë dhe për Maqedoninë dhe që bënë për Shqipërinë pakrahismisht me shumë se këta", u shpreh Rama.



Kryeministri Edi Rama

LUAN RAMA

"Nuk ka një datë për çeljen e negociatave dhe, nëse rekomandimi ka një datë, unë jap dorëheqjen sot ose këtë ta bëjë kryeministri. Nuk e kam për turp të jap dorëheqjen e të iki nga parlamenti nëse jepet rekomandimi pozitiv qershorin e vitit të ardhshëm", u shpreh zv. kryetari i LSI-së, Luan Rama, në seancën e djeshme.

DITMIR BUSHATI

Ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, ftoi nga foltorja e Kuvendit deputetët e opozitës të lexojnë si duhet vendimin për negociatat. "Nëse duam të bëjmë një diferencë në këtë proces, është të përcaktojmë një plan pune për atë reforma, të cilat nuk kanë të bëjnë as me ne, as me ju, as me Europën, në fakt, por me të ardhmen e fëmijëve tanë", u shpreh ai.



Ballë publikon foton: Basha me vëllain e Vladit, në kërkim për 3.4 mln euro

Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Ballë tregoi dje, në Kuvend një foto, në të cilën sipas tij është kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha në zyrën e tij me vëllain e dy porositësve të "Toyota-ve" të bllokuara me 3.4 milionë euro. "Ja ku je me vëllain e personave të shpallur në kërkim për pastrim parash në zyrën tënde Lulzim. Kjo është provë e pakundërshueshme. Këtë provë do t'ia dorëzoj drejtësisë. Ky derdimit është një njeri, jo i paaftë, por një budalla që njofton vëllain e mikut nga Kuvendi që mos t'i bjerë nga Ankona, por t'i bjerë nga Bari. Dyshoj se 'Toyotën' e prisje ti Lulzim", u drejtua Ballë, Bashës. "Je i përfshirë në pastrim parash. Të kam kallëzuar Lulzim", - tha Ballë. "I vëllai i dy personave të shpallur në kërkim foto me Bashën në zyrat e PD. A u shërbeu Basha vëllait të tyre?" - ka deklaruar Ballë nga salla e Kuvendit, teksa në dorë mbante edhe fotografimin. Më tej Ballë u shpreh se Basha përmes deklarameteve të tij ka vënë në rrezik operacionin e policisë. "Njofton vëllain e mikut nga foltorja e Kuvendit që të mos kalonte nga Ankona. Dyshoj se 'Toyota Yaris' po e prisje ti. Vure në rrezik një operacion të suksesshëm policie", - tha Ballë, ndërsa vetë kreu i PD-së ka lënë sallën e seancës. Në padinë e dorëzuar një ditë më parë në prokurori, Ballë pretendon se kreu i Partisë Demokratike ka përhapur qëllimisht sekretin hetimor; duke shtuar se, "për sa u përket këtyre deklaratave, unë mendoj se këto janë bërë nga i kallëzuar, pasi ai e ka kuptuar ndikimin e veprimtari të tij kriminal dhe ka dashur që ta kalojë në diskursin e tij të zakonshëm politik dhe publik".

Fatmir Xhafaj-Bashës: Bëj kujdes kur aludon shërbime partnere inteligjente

Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj paralajmëroi dje, kreun e PD-së, Lulzim Basha që të bëjë kujdes. Pas akuzave të kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Basha lidhur me 3.4 milionë euro që u sekuestruan në Portin e Durrësit, në makinat "Toyota", Xhafaj i ka thënë Bashës të tregojë me emër dhe mbiemër agjencitë e huaja të specializuara që ka dhënë informacionin. "Opozita në këtë sallë, dhe ata të cilët nga ligësia, apo dhe ata që nga naiviteti, apo nga lodhja nervore dhe shpirtërore me këtë realitet politik, më kërkojnë dorëheqjen në emër të moralit politik e njerëzor; duhet ta kursejnë këtë kërkesë për mua, të paktën për këtë rast. Balta që kërkoni të hidhni tek unë në mënyrën e pamerituar dhe në mënyrën më të shëmtuar me lloj-lloj akuzash dhe intrigash, nuk e pastron kurrësi baltën që ju ka mbuluar ju me bëmat e së kaluarës dhe me bëmat e të tanishmes. Për këtë jam i vetdijshëm jo vetëm unë, por i gjithë publiku që ju shikon dhe ju gjykon", u shpreh Xhafaj. "Është fare e lehtë sot që të mbyllësh hesapet politike me Lulzim dhe me kulturën politike që përfaqëson. Ka qenë ministër i Brendshëm njëherë e një kohë dhe, nëse do që të krahasohet për punë dhe rezultate, të urdhërojë, të hapur e ka mejdani! Le të dëshmojë çfarë punë ka bërë e çfarë gjurmë ka lënë! Por këto sfida, të cilat i ka të humbura që në fillim, dihet se nuk i interesojnë, ndaj ka gjetur strehtë tek 'Babale-zbulimet' dhe spiunimet", u drejtua Xhafaj, Bashës. "E meqë ra fjala, vijoi ministri më tej, ka ardhur dita që pesha e fjalës së cilitdo politikani të matet me përgjegjësinë publike, që ai merr pasi e pohon. Ndaj, Lulzim, bëj kujdes kur aludon shërbime inteligjente partnere, për informacione të dhëna gjoja prej tyre, në trillet e sajara prej teje, ose përndryshe gjë gjuximin të thuash emër e mbiemër! Bëj kujdes se jo vetëm bëhesh qesharak mes tyre, por edhe se nuk dihet se në çfarë dërrase tjetër të kalbur je duke shkelur!"

troj këtë kërkesë dhe do t'ju kthejmë përgjigje. Do t'ju kthejmë përgjigje, patjetër, por kur të jemi pushim, domethënë, ka kohë", ironizoi më tej, Rama. "Ne kemi datën për negociatat. Këta thonë 'jo', se qershorin e kanë problem, se në qershor i pësojnë të gjithë ato goditjet dhe po panë qershor, thonë nuk ka shans që të jenë poziti-

Presidenti Meta i jep nënshtetësinë shqiptare ish-drejtuësve të Kosovës

Presidenti i Republikës i ka dhënë shtetësinë shqiptare disa personaliteteve të politikës së Kosovës. Kështu, sipas dekretit të kreu të shtetit, shtetësinë shqiptare e kanë përfutur ish-presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu dhe ish-kryeparlamentari, Jakup Krasniqi. Presidenti i Parë i Republikës së Kosovës, Fatmir Nexhmi Sejdiu, ka përfutur me kërkesën e tij shtetësinë shqiptare. Bashkë me ish-presidentin, shtetësinë e ka marrë edhe grua ja e tij Nezafete Sejdiu dhe djali Bardhyl Sejdiu. Dhënia e shtetësisë shqiptare i është akorduar edhe ish-kreut të parlamentit dhe ish-presidentit në detyrë të Kosovës, Jakup Januz Krasniqi. Ashtu si Sejdiu, dhënia e shtetësisë për Krasniqin është dekretuar pas kërkesës së tij, së bashku me anëtarët e familjes, gruan dhe tre fëmijë.

tiv. Jo, qershori nuk është pozitiv për ju. Qershori është hija që ju ndjek e do vazhdojë t'ju ndjekë nga pas. Ja, do vijë qershori tjetër, rrugës është dhe qershori tjetër, një rrugë e dy punë, t'ju rregullojmë mirë siç e meritoni dhe të hym në finalizimin e procesit, duke organizuar Konferencën Ndërqeveritare për Negociatat", u shpreh Rama. Sipas tij, "në korrik vjen ekipi i Komisionit Europian, pikërisht për programin analitik, 'screening' ia thonë në anglisht". Ai e cilësoi fatkeqësi që nuk ka një opozitë as për ekonominë, as për punësimin, as për zhvillimin rural, as për turizmin, as për arsimin, as për shëndetësinë. "Duhet të pajtohemi me këtë fatkeqësi. Nuk kemi opozitë. Opozitën e kemi në terren. Opozitën e kemi në rrjetet sociale. Opozitën e kemi në mexhlinis ku jetojnë njerëzit. Opozitë kemi hallet dhe problemet e tyre dhe me ata do qëndrojmë", u shpreh kreu i qeverisë. "Mirë e tha një nga etërit themelues, o Zot, e kufizove inteligjencën, po budallallëkun pse e le pa kufi? Pse o Zot, e le pa kufi!", u shpreh Rama, ndërsa la sallën e Kuvendit.

INTEGRIMI REAGIMET

Komisioni European: Do shoqërojmë dy vendet në përpjekjet për reformat

Negociatat në 2019, Hahn: Përgatitjet për bisedimet do të fillojnë menjëherë

"Gota është pothuaj 90 për qind e mbushur"

Darina Tanushi

Përgatitjet për fillimin e bisedimeve me Shqipërinë dhe Maqedoninë do të fillojnë menjëherë, deklaroi Komisioneri evropian për Zgjerimin, Johannes Hahn, në një intervistë për radion "Europa e Lirë". Hahn theksoi se me vendimin e Këshillit për Çështje të Përgjithshme, Komisioni ka marrë dritën jeshile për të nisur punën që do të mundësojë nisjen e negociatave zyrtarisht nga mesi të vitit të ardhshëm. "Do të duhen më shumë se 100 konferenca ku duhet të analizohen elemente të ndryshme. Kjo është një sfidë për qeveritë, veçanërisht për administratën", - theksoi Hahn. "Qytetarët e Shqipërisë dhe Maqedonisë duhet ta shohin këtë nga perspektiva shumë pozitive", - shtoi ai. "Nuk do të doja të thosha gjysmë gote e mbushur, por pothuaj 90 për qind e gotës është e mbushur, pasi shumica dërrmuese e vendeve anëtare i njohën arritjet e tyre dhe duhet të kuptohet se ky është përkushtim shumë i fuqishëm i liderëve politikë, gjithashtu, edhe nga qytetarët, për vendosmërinë në lidhje me perspektivën e tyre evropiane. Dhe kjo është mundësi e mirë për t'i bindur tri vendet se qasja e tyre skeptike nuk është e justifikueshme", - thotë Hahn. "Shpresoj të mos humbim kohë, nuk do të presim deri në vjeshtë për të filluar punën", - thekson Hahn. Ndërkohë zëdhënësja e Komisionit Evropian, Maja Koçiançiq tha, gjithashtu, djeh, në një reagim për "Ora News", se menjëherë pas vendimit të Këshillit Evropian, Komisioni do të nisë punën përgatitore me Shqipërinë ose siç njihet ndryshe "procesi screening". Koçiançiq tha, gjithashtu, se Komisioni do të vijojë angazhimin për të mbështetur Shqipërinë në përpjekjet për reformat si përgatitje për të hapur negociatat. Pas vendimit të vështirë pas orëve të gjata të diskutimit, Shqipërisë i është dhënë një shans i ri për në qershor të vitit 2019 për të hapur negociatat duke përmbyshur njëkohsisht edhe kërkesat e Këshillit Evropian në këtë kohë. "Komisioni do të vijojë angazhimin për të shoqëruar Shqipërinë dhe ish-Repub-



Komisioneri evropian për Zgjerimin, Johannes Hahn



Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias, ka deklaruar se Greqia dhe Shqipëria ndodhen në përfundim të negociatave për marrëveshjen e delimitimit të zonave ekskluzive ekonomike. "Ka pasur një negociim më të hershëm, kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë për një zbatim jo të saktë të së drejtës ndërkombëtare, pati disa çështje teknike dhe tashmë jemi në përfundim të këtyre negociatave", - tha Kotzias gjatë një interviste për radion vendase News 24/7, të enjten. Ministri i Jashtëm grek dha edhe disa detaje lidhur me pritisshmëritë e Athinës nga këto negociata. "Ne duam të kemi 100 influencën mbi ishujt, posaçërisht atyre që janë sipër Korfuzit e para së gjithash Otonoit. E them këtë sepse, në marrëveshjen e vitit 2009, e morëm influencën 100%. Por Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë bëri një konstatim: se në marrëveshjen që bëri Kostandinos Karamanlis në 1997 për shelfin kontinental me Italinë, influen-

Ministri i Jashtëm grek: Nuk pranova kurrë të diskutojmë për Çamërinë

Marrëveshja, Kotzias: Ujërat territoriale do t'i shtrijmë gradualisht në 12 milje



Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias

ca që vetë Karamanlis i dha Otonoit ishte 70%. Rrjedhimisht ka një vështirësi ligjore, por besoj se do ta kapërcejmë në maksimum", tha Kotzias. Sa i përket shtrirjes së mëtejshme të ujërave territoriale në 12 milje, ministri i Jashtëm grek tha se kjo do të bëhet gradualisht. Ai e barazoi këtë lëvizje me një zgjerim të horizontit territorial. "Do të jetë hera e parë që Greqia, pas dekadash, do të

zgjerojë horizontin e saj territorial". I pyetur nëse delimitimi i zonave ekskluzive ekonomike me Shqipërinë, do të influencojë edhe përgjasjen ndaj mosmarrëveshjeve greko-turke, Kotzias u përgjigj: "Do të fillojmë nga Shqipëria që kemi delimitimin e ZEE dhe shpresoj të mos kemi keqkuptime nga ana e Turqisë, sepse do të avancojmë dalëngadalë". Në intervistë, ministri i Jashtëm grek mo-

MICHAEL ROTH

Ministri gjerman i Shtetit për Çështjet e Europës, Michael Roth tha dje: "Nuk ka pazare ndërmjet Bashkimit Evropian dhe këtyre dy shteteve. Ne ia njohim Ballkanit Perëndimor që deri tani ka bërë shumë për pranimin e refugjatëve. Më duket e padrejtë të ushtrohet presion ndaj këtyre dy shteteve, sepse njëra nuk ka lidhje me tjetrën".



Liderët e PES:

Përpjekje heroike, Edi Rama e ka merituar rrugëtimin e tij në BE

Qeveritë Progresiste në Shqipëri dhe Maqedoni bënë të mundur për të dy vendet që të arrihej data e fillimit të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ky ka qënë mesazhi nga takimi i kryeministrave të majtë para saminit të Partive Socialiste Europiane, të cilët në një reagim publik unanimit thonë se "Edi Rama dhe Zoran Zaev e kanë merituar rrugëtimin e tyre në BE". Presidenti i Partive Socialiste Europiane, Sergei Stanishev tha në takim se "është e qartë që përpjekjet heroike të dy qeverive, në Tiranë dhe në Shkup për të përgatitur vendet e tyre për negociatat e anëtarësimit në BE, po japin në më fund frytet e tyre". Stanishev tha se vendimi pozitiv për dy vendet "do të ndihmojë në sigurinë dhe stabilitetin jo vetëm të rajonit, por të të gjithë Europës dhe për të dy vendet që të zënë vendin që u takon me të drejtë, në tryezën e BE".

Permbuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shtjpe ne ankand pasurine :
 a) Toka are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurite 532/1, volumi 10, Fage 248, ne zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 3230 m2, e ndodhur ne adresen Barbulush Shkoder b) Toka are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurite 523/21, volumi 9, Fage 3, ne zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 2360 m2, e ndodhur ne adresen Barbulush Shkoder 2. Çmimi me të cilin do të fillojë shiti ne ankand për pasurinë e sipërpëshkruar, është në vlerën për pasuritë "Toka Are" me sip 3230 m2, është në vlerën 488,376 leke
 Për pasurine "Toka Are" me sip 2360 m2, është në vlerën 356,832 leke
 Shiti e pasurisë filloj me date 04.07.2018 ora 16:15 ne Zyren e përmbaruesit gjyqësor Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko, Përballe Gjyqates se rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet te derchin përpara fillimit te ankandit 10% te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051.

likën Jugosllave të Maqedonisë në përpjekjet e tyre për reforma, në përgatitjen e tyre për të hapur negociatat e pranimit në qershor 2019. Në këtë kontekst, Komisioni do të fillojë punën e nevojshme përgatitore. Kjo përfshin kontrollin teknik të legjisllacionit (screening) si dhe përgatitjen e kornizës së negociatave", u shpreh Koçiançiq. Procesi i njohur "screening" është një ushtrim tërësor që udhëhiqet nga Komisioni, për të përgatitur negociatat për anëtarësim. Ky proces i jep mundësi vendit kandidat për t'u përshatur më tej me legjisllacionin eu-

ropian dhe lejon Komisionin të vlerësojë përgatitjen e vendeve kandidatë. Tipikisht, ky proces zgjat më shumë se 1 vit dhe siguron një bazë të qëndrueshme për vendimin që do të marrin vendet anëtare për kaptujt dhe negociatave për anëtarësim.



Valentina Madani

Kuvendi i ardhshëm dhe drejtuesit e rinj të pushtetit lokal nuk do kenë më ish-bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit. Çdo kandidat për zgjedhje do të kalojë filtrin e Autoritetit të Dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit. Në funksion të kësaj, Autoriteti për Informimin mbi dosjet e ish-bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Shtetit ka nisur mbledhjen e dokumenteve të periudhës së diktaturës në arkivat shqiptare. Kreu i këtij institucioni, Gentiana Sula zbardhi dje në Kuvend shifrat e dokumenteve të gjetura. "U identifikuan rreth 32 milionë faqe, apo 2.3 km fond arkivor, në letër dhe mikrofilma, 80% e fondit. Rreth 9000 dokumente janë deklasifikuar në vitin e parë", tha zj.Sula. Në raportin e paraqitur në parlament, ajo ka dhënë edhe shifrat e ish-bashkëpunëtorëve që kanë tentuar të kandidojnë apo të jenë pjesë e administratës. "Kanë kaluar në filtrin e verifikimit të pastërtisë së figurës rreth 821 kandidatë apo zyrtarë, përpara emërimit apo ngritjes në detyrë, kurse 13 persona figuruan pozitivë në kërkim", theksoi zj.Gentiana Sula. Një fluks të lartë kërkesash Sula pret edhe prej Policisë së Shtetit. "Presim një fluks shumë të madh përsa i përket verifikimit të figurave me aprovimin nga parlamenti të ligjit të vetingut të policisë, ku ne presim 12000 anëtarë të personelit të policisë të kalojnë në filtrat tanë. Kështu që bëjmë thirrje për të plotësuar atë numër të personelit, i cili është aprovuar në këtë parlament në dhjetor të 2016 dhe në vend të 25 personave që kemi sot, kemi 55 persona të sekretariatit teknik", u shpreh zj.Sula. Ajo gjatë raportimit nënvizoi se për publikun do të hapen edhe dosjet e periudhës së mbretit Zog, por edhe të Kosovës.

SFIDA
Kryetarja e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Sula e cilësoi si sfida të këtij institucioni krijimin e kushteve për ruajtjen e dosjeve dhe financimin e këtij institucioni. 12 mijë persona, personel i policisë sipas saj duhet të kalojnë në filtra. Sula e konsideron si domosdoshmëri mbështetjen e këtij institucioni, sepse fluksi është në rritje, madje theksoi se 12 mijë punonjës të policisë do të kalojnë në sitën e këtij institucioni. "Problem janë kushtet fizike të ruajtjes së fondeve dhe radhët e gjata

Hetimi i dosjeve të Sigurimit, kreu i Autoritetit bën bilancin para deputetëve

Sula: Çdo kandidat në filter, jo më ish-sigurimsa në politikë

"Ish-bashkëpunëtorët që tentuan të kandidojnë"



Gentiana Sula, kreu i Autoritetit të Dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit

SKANERI

Autoriteti kërkon që zyrtarët dhe politikanët të kalojnë në mënyrë automatike skanerin e tij. Gentiana Sula theksoi se duhet të mbështetet iniciativa për përmirësime ligjore dhe procedurale.

FILTRI

"Kanë kaluar në filtrin e verifikimit të pastërtisë së figurës rreth 821 kandidatë apo zyrtarë, përpara emërimit apo ngritjes në detyrë, kurse 13 persona figuruan pozitivë në kërkim", tha zj.Sula.

POLICIA

12 mijë persona, personel i policisë të kalojnë në filtra. Sula kërkon mbështetjen e këtij institucioni teksa tha se 12 mijë punonjës të policisë do të kalojnë në sitën e këtij institucioni.

TAKIMI



Vendimet e Maqedonisë, Berisha takon Zoran Zaev

Ish-kryeministri Sali Berisha është takuar me kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev, të cilët ndodhen në forumin e 'Crans Montana'. Lajmi është bërë i ditur nga vetë ish-kryeministri me anë të një postimi në rrjetet sociale, ku shprehet se me Zaev biseduan për çështje të ndryshme dhe takimi ishte i hapur. "Në forumin e 'Crans Montana', në një takim me kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev duke diskutuar për zhvillimet në të dyja vendet tona. Shfrytëzova rastin të uroj kryeministrin për vendimet e tij të rëndësishme për vendin e tij dhe rajonin. Pata kënaqësi për njoftimin që kryeministri më dha për tenderin që qeveria e tij ka hapur për ndërtimin e segmentit të hekurudhës, që lidh dy rrjetet tona hekurudhore. Takimi ishte i hapur", shprehet z.Berisha.

"Raportet ndërkombëtare nuk kanë qenë të sakta"

Negociatat, Kryemadhi: Rama s'është normal, i lumtur për moshapjen



gocitave me BE. "Opozita në mënyrë unisone i ka çuar letër komisionerit Hahn për hapjen e negociatave. Vendi nuk i intereson. Hapja e ne-

me Ramën, ishte për shqiptarët. Njeriu më i lumtur për moshapjen e negociatave është Edi Rama. Vetë Ramës nuk i intereson. Hapja e ne-

gociatave do të thotë rregulla për qeverisjen. Reagimi i këtij njeriu... Ose ky nuk është normal, ose është djalli vetë. Nuk shoh entuziazëm, por më shumë një cover për të mbuluar një realitetin e hidhur. Edhe ndërkombëtarët janë pak shqakarrë të situatës në Shqipëri. Për hir të së vërtetës, 8 kushtet që na janë vendosur, opozita ka më shumë se 1 vit që i artikulon, por në institucionet ndërkombëtare raportet nuk kanë qenë të sakta", tha zj.Kryemadhi.

të qytetarëve. Materialet janë të një trashëgimie të madhe kulturore. Materialet kërkojnë të ruhen dhe kërkoj vëmendjen e parlamentit dhe të qeverisë, sepse dokumentet duhen ruajtur. Numri i kërkesave është rritur. Kemi dyfishim të kërkesave për individë dhe katërfishim të kërkesave për studiuesit dhe mediat. Presim një fluks përsa u përket fig-

urave me aprovim nga parlamenti për vetingun e policisë dhe po na presin 12 mijë persona të personelit të policisë të kalojnë në filtrat tanë", u shpreh Gentiana Sula. Ajo apelon se zyrtarët dhe politikanët duhet të kalojnë në mënyrë automatike skanerin e Autoritetit. Sula theksoi se një kërkesë tjetër e institucionit që e ka diskutuar edhe në Komisio-

ni e Ligjeve dhe të Drejtave të Njeriut është të mbështetet iniciativa për përmirësime ligjore dhe procedurale. "Kemi katër kërkesa për ndryshimet ligjore. Së pari, kërkesa për verifikim të figurave të larta të mos jetë 2020, por të shtyhet. Së dyti, verifikimi të mos varet nga kërkesa e kandidatëve për institucionet, por të jetë automatik, këtë e kemi parë

në Bullgari dhe funksionon. Së treti, meqenëse po bëhet reforma zgjedhore, mendoj se duhet të ketë disa parashikime të caktuara që të lejojnë kandidatët të kalojnë në filtrin e institucionit tonë. Dhe e katërta, kërkojmë që institucionit të kthehet në një institucion të plotë përkujtimi e të trajtojë çështjet pa kufizime të ngurta kohore", theksoi Sula.

'Toyota' me euro, gjykata lë në burg 4 të akuzuarit. Zbardhen dëshmitë dhe rolet e tyre

Klodiana Haxhijaj

Ina Allkanjari

"Ishte hera e tretë që sillnim makina nga Belgjika, ngarkesën e priste Alfred Vladi"

Shoferi Agim Çeku: Ndryshuan itinerarin e udhëtimit nga Ancona në Bari

Gjykata e Durrësit ka vendosur ditën e djeshme masën e sigurisë "arrest me burg" për katër të arrestuarit në lidhje me 3.4 milionë eurot e zbuluara në dy makina "Toyota Yaris" disa ditë më parë në Portin e Durrësit. Sipas vendimit, shtetasit Alban Mollaymeri, Agim Çeka, Edi Lika dhe Klevis Lika do të mbeten në burg deri në përfundim të hetimeve. Po kështu gjykata e Durrësit ka vendosur mos-kompetencën,

pasi dolën në konkluzionin që kemi të bëjmë me një grup të strukturuar kriminal dhe çështja transferohet te Krimet e Rënda për gjykimin e mëtejshëm. Nderkohë dalin në dritë të tjera detaje dhe dëshmi nga dosja në ngarkim të katër të akuzuarve. Ata do të përballen me akuzën "Pastrim të produkteve të veprës kriminale ose veprimtarisë kriminale" në bashkëpunim. "Gazeta Shqiptare" ka siguruar dosjen e prokurorisë ku hidhen dyshime se të akuzuarit dhe dy të shpallurit në kërkim kishin gjetur me këtë mënyrë një formë të pastrimit të parave të krim-it.

DOSSJA
"Fakti që këta persona kanë bërë këtë rrugë 2 herë të tjera brenda pak javëve tregon për testim të kësaj forme të pastrimit të parave përmes transportit rrugor-detar, rrugëtime që kanë rezultuar të suksesshme dy herët e para. Dyshimi që mund të kenë kaluar para edhe në dy rastet e para ekziston, por deri në këto momente nuk ka ndonjë të dhënë konkrete. Megjithatë për këtë grup kriminal do të vazhdojmë hetimet", thuhet ndër të tjera në dosjen e siguruar. Nderkohë secili prej tyre rezultoi të ketë rolin e tij në këtë grup të strukturuar. "Elvis Vladi ka dalë nga Shqipëria më 19.04.2018 dhe ka shkuar në Belgjikë. Ai është marrë me organizimin e gjetjes së mjeteve për transportin e parave që vijnë nga aktivitetet kriminale dhe pasi është siguruar që ato po transportoheshin ka ardhur në Shqipëri me avion në datë 20 qershor 2018, pikërisht për të bërë pritjen e parave të pista.

Nga ana tjetër, Edi Lika dhe Klevis Lika kanë marrë përsipër pjesën e transportit të parave. Alfred Vladi po bënte pritjen e mjeteve në



4 të akuzuarit në sallën e gjyqit

portin e Durrësit ndërsa Alban Mollaymeri do bënte zhdoganimin e tyre", sqarohet ndër të tjera. Nderkohë me rëndësi në dosjen e prokurorisë është dëshmia e Agim Çekut, 61-vjeçari që kishte nisur punë prej një muaji në kompaninë e transportit të Edi Likës. Ai flet për një rrugë të gjatë dhe mundimshme që e bënte për herë të tretë dhe tregon me detaje se ngarkesën me makina "Toyota Yaris", ua ka dorëzuar shtetasit Elvis Vladi në Belgjikë, ndërsa zhdoganimin në Durrës pritej ta bënte kushëriri i tij Alfredi, djali i khaxhait. "Prej një muaji ka punuar si shofer tek kompania e shtetasit Eduard Cani, Edi Lika i cili ka një firmë që transporton automjete me një trajler me targa AA120SP/AFR 559 nga vendet e Europës për në Shqipëri, Tiranë, me qendër në Allias. Me këtë firmë ai deklaroi se ka bërë tre rrugë në Belgjikë", thuhet në dosje.

ITINERARI I TRAJLERIT

Më datë 12.06.2018 shoferi Agim Çeku deklaroi të ketë marrë një telefonatë nga pronari i tij për të marrë trajlerin në Tiranë e të niseshin bashkë me djalin e tij Klevis Canin për në Belgjikë ku do ngarkonin disa makina për t'i sjellë në Shqipëri. Më datë 13 ata janë nisur në mëngjes herët, kanë kaluar kufirin

nga Hani i Hotit në Mal të Zi, pastaj në Kroaci, Slloveni, Austri dhe Gjermani. Në datë 16 kanë mbërritur në qytetin Sherlo të Belgjikës që rezultoi të ishte edhe destinacioni i tyre. Kanë qëndruar dy ditë aty dhe kanë fjetur dy ditë në trajler në pritje të makinave. Në këtë vend ai deklaroi të ketë qenë edhe një herë tjetër. Kur kanë shkuar atje kanë kontaktuar me shtetasin Elvis Vladi, i cili i ka ngarkuar mjetet Toy-

Parat në Portin e Durrësit, avokati Saimir Vishaj: Katër të arrestuarit janë viktima

Ndërsa gjykata e Durrësit ka vendosur të lërë në burg 4 personat e arrestuar për eurot e zbuluara në Portin e Durrësit, avokati i babë e bir Edi dhe Klevis Lika, Saimir Vishaj në një deklaratë për mediat shprehet se ata janë viktima. Pas vendimit të gjykatës, Vishaj ngriti disa pikëpyetje, ndërsa theksoi se është e pamajinueshme që 4 të arrestuarit të bëjnë trafikun e parave. "Të katër personat u lanë

në burg. Të arrestuarit janë viktima në këtë rast. Askush nuk thotë ku janë futur paratë në Belgjikë apo Itali. E pamajinueshme që 4 të arrestuarit të bëjnë trafikun e parave", deklaroi ndër të tjera Vishaj. Pas zbulimit të 3.4 milionë eurove në portin e Durrësit policia vuri në pranga Alban Mollaymerin, Agim Çekën, si dhe pronarin e kamionit me të cilin transportoheshin makinat Edi Lika dhe të birin Klevis Lika.

miln eurove në dy makina "Toyota Yaris" në portin e Durrësit. Përpara grupit hetimor Lika pranoi se ka një kompani që transporton makina, por hedh poshtë të ketë dijeni për transportin e parave. Nga ana tjetër, ai nuk sqaron se pse kur ishin në Belgjikë telefonoi shoferin e firmës së tij dhe i tha të ktheheshin nga porti i Barit dhe jo nga Ancona, siç ishte parashikuar më herët. "Edi Lika ka pranuar se ka një aktivitet privat së bashku me djalin e tij Klevis Cani. Kamionin bizzar apo trajlerin që transporton makina që e kanë blerë në muajin janar 2018. Ai deklaroi se kanë hapur një adresë në "Instagram" "Autotransport Europa" dhe nëpërmjet kësaj adreshe marrin porosi nga persona të ndryshëm për të sjellë makina në Shqipëri. Ai ka deklaruar se 7 makina "Toyota" janë marrë në Bruksel një makinë tip Alfa në Liezh, kufi me Gjermaninë dhe një automjet tip Opel është ngarkuar Aachan në Gjermani. Automjetet tip "Toyota" thotë se i kishte porositur Fredi personi që ka një biznes në Laprakë ku jep makina me qira. Ai mohon të ketë lidhje me ngjarjen dhe thotë se porositësi i tyre ishte Fredi", thuhet në dosje.

DËSHMIA E ALBAN MOLLAYMERIT

Tjetër dëshmi me vlerë është ajo e Alban Mollaymerit, i cili deklaroi se ka një servis privat për makina. Ai deklaroi se muaj më parë ka porositur disa makina "Toyota" nëpërmjet mikut të tij Alfred Vladi. Këtu makina ata i gjenin në internet dhe i porosisnin jashtë Shqipërisë. Makinat e porositura i kanë ardhur dhe ai ka shkuar e bashkë me Alfredin kanë bërë zhdoganimin. Por ai mohon të jetë porositësi për ndonjë prej "Toyotave" të ardhura në datë 24/6/2018. Nderkohë nga të dhënat telefonike rezultoi se ky shtetas ka komunikuar me Alfred Vladin pikërisht në momentin që është bërë bllokimi i mjeteve në portin e Durrësit.

Gruaja e shoferit shpërthen në vaj në gjyq: S'kemi bukë të hamë

Gjatë aktimit të masës së sigurisë për katër personat që kanë përfunduar pas hekurave për 3.4 milionë euro të zbuluara në dy mjete "Toyota", prezente në sallën e gjyqit ka qenë edhe gruaja e Agim Çekës, shoferit të kamionit me të cilin po transportoheshin paratë.



por më pas sapo ka parë të shoqin 61-vjeçar pas kafazit të xhamit është shkrehur në vaj dhe është nxjerrë jashtë. "Burri im ka qenë i papunë. Kishte një muaj që kishte fil-

luar. E shkreta unë ç'më gjeti! Ku do gjej para ta nxjerrim nga burgu?! Burri im nuk ka lidhje me lekët. I thotë pronarit ik atje, hajde këtu atë bën. Ku do vemi ne? Hajdeni shikoni shtëpinë, ne jemi copë-copë, s'kemi ç'të hamë. Le të kapin ata që e kanë bërë këtë punë. Kush do ta nxjerrë tani nga burgu burrin plak. Ne s'kemi lekë të hamë bukë jo ta nxjerrim nga burgu", tha bashkëshortja e Agim Çekës i akuzuar si pjesë e një grupi të strukturuar kriminal dhe për "pastrim parash".

ZYRA PËRBARIMORE HERËT ENRËJETA ZISI
Permbarese gjygesore private Enrjeta Zisi zhvillon ankandin për shitjen e pasurisë se paluajtshme "Apartamenti" me sipërfaqe 82.1m2, ZK.3866, Nr.Pasurie.300/143+1-7.Vol.83.Fq.186.Indeksi i Hartes K-34-100, te ndodhur në Tiranë, Yzberisht pranë rruges "Joklin Pansj", kati i 3, shk.1 ap.7 Tiranë, për shlyerjen e detyrimit në favor të kreditorit "Yzeir Lianaj".
Çmimi i ri me të cilin shpallet ankandi është në shumën 3.010.392 (tre milion e dhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) lekë.
Ankandi zhvillohet në datë 04.07.2018, ora 16.00 në zyrën e Permbarese gjygesore private Enrjeta Zisi, Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati "Gora"Kulla.2,Kati i 2, Tiranë Nr.Tel. 0694799000, email:enrjeta.zisi@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përbarimore "Best 2010"
Më datë 3 korrik 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 tek kjo zyre përbarimore do zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë së shpërbërë "Komfort" Shqipëri.
Apartamenti/zyra që do të shitet ndodhet në ZK 8310, Rr"Drilon Hoxha", Tiranë (kati 7) 1ndretesës, mbi zyrat e Bankës NBBG).
Prona është e deblitit e nuk rëndohet nga asnjë detyrim tjetër civil.
Çmimi fillestar me të cilin hapet ankandi është 11.772.000 lekë.
Çmimi fillestar edhe në euro sipas kursit të këmbimit ditës.
P.s: Ouletuarit/sujetuarit që dëshirojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të çmimit fillestar si garancë për pjesëmarrje në ankand. Kjo garancë pasurore duhet të jetë e dorëdhur në BKT, nr. Illogariste Saimir Hoxha FF (IBAN: AL07 2051 2046 4206 9831 PRICJALLA)
Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës, Telfax: 052-22-4000
E-mail: best.2010@perbarbues.al, web: www.perbarbues.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përbarimore "Best 2010"
SHPALLJE ANKANDI
Më datë 16 korrik 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 tek kjo zyre përbarimore do zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë nr.5826, vol 17, fq 3 të ndodhur në L.13, ZK.8516, Plazh, Durrës. Truallit që ka sipërfaqen prej 600 m² kufizohet sipas një marrëveshjeje sipërmarjeje. Prona është e vëllëzërve, z.Arben e z.Shkëlqim Riza Brameta
Çmimi fillestar me të cilin hapet ankandi do të jetë 570020 Euro.
Çmimi mund të llogaritet edhe në lek sipas kursit të këmbimit ditës.
Ofertuesit duhet të kenë depozituar në Illogarinë e zyrës përbarimore 10% të çmimit fillestar.
Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës, Telfax: 052-22-6000
E-mail: best.2010@perbarbues.al, web: www.perbarbues.al



Vendi ku ndodhi përplasja me armë zjarri


Tentoi të dëmtojë pamjet e kamerave të sigurisë, bie në pranga 29-vjeçari, Ervis Bano

Ina Allkanjari

Plagosja në Kinostudio, si nisi sulmi me armë ndaj vëllezërve Mumajesi e Durollarit

Prishja e pazareve të drogës, banorët: Dëgjua disa të rinj që po debatojnë

Një luftë me armë zjarri ka tronditur mesnatën e së enjtes lagjen "Kinostudio" në kryeqytet. Një konflikt, i cili dyshohet të ketë nisur për shkak të prishjes së pazareve të drogës dhe luftës për territor mes dy grupeve rivale, ka çuar deri në përdorimin e armëve. Si pasojë e përplasjes kanë mbetur të plagosur tre persona, konkretisht dy vëllezërit Rivellino Mumajesi dhe Juxhin Mumajesi, si dhe 28-vjeçari Ibrahim Durollari. Mësohet se shënjestra e sulmit kanë qenë dy të rinjtë Mumajesi. Të tre shtetasit e mësipërm i transportuan menjëherë për në spitalin e Traumës me mjetet e rastit, ku mësohet se dy vëllezërit ndodhen jashtë rrezikut për jetën, ndërsa i plagosuri i tretë Ibrahim Durollari ndodhet në gjendje të rëndë. Uniformat blu bëjnë me dije se nga veprimet e deritanishme hetimore, në vendngjarje janë gjetur dhe sekuestruar 9 gëzhoja. Ndërkohë i vetmi person, i cili ndodhet pas hekurave është 29-vjeçari Ervis Bano. Kjo pasi dyshohet se Bano ka marrë serverin e kamerave të një biznesi në zonën ku ndodhi ngjarja, dhe ka tentuar ta dëmtojë, për të fshehur pamjet. Ndërkohë mësohet se deri tani janë shoqëruar rreth 23 persona në ambientet e policisë, të cilët dyshohet se kanë dënuar për ngjarjen. Sakaq po punohet për identifikimin dhe kapjen e autorëve si dhe për zbardhjen e plotë të ngjarjes.



Vendi ku ndodhi ngjarja

Më datë 28.06.2018, rreth orës 23:54 në rrugën "Aleksandër Moisiu", në një lokal bastesh kanë mbetur të plagosur me armë zjarri nga persona ende të paidentifikuar, shtetasit Juxhin Mumajesi 24 vjeç, Rivellino Mumajesi 36

vjeç dhe Ibrahim Durollari 28 vjeç. Ky i fundit mësohet se po i nënshtrohet një ndërhyrje kirurgjikale në spitalin e Traumës, dhe ndodhet në gjendje të rëndë. Ka dyshime se pjesëtarë të një grupi rival iu afruan personave që mbetën të plagosur dhe hapën zjarr ndaj tyre. Edhe këta të fundit iu kundërpërgjigën po duke qëlluar me armë zjarri. Bëhet e ditur se Durollari, ndodhet në gjendje të rëndë dhe i intubuar, ndërsa dy të tjerët ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Burime nga policia thanë se motivi i kësaj ngjarje lidhet me tregun e narkotikëve, dhe përplasja ka ndodhur mes 2 grupeve rivale për territoret e shitjes. Vetëm disa orë pas përplasjes me armë mes dy grupeve rivale, uniformat blu arrestuan një person. Ai është

banues në Tiranë (për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal). Nga veprimet e tanishme hetimore në vendngjarje janë gjetur dhe sekuestruar 9 gëzhoja të qitura nga armë zjarri të llojit pistoletë të përdorura nga autorët", thuhet në njoftimin e policisë.

Gjithashtu, mësohet se një nga personat e plagosur, 36-vjeçari Rivellino Mumajesi, nuk është një emër i panjohur për policinë. Kjo pasi ai në mars të 2017-ës është përfshirë në plagosje me armë zjarri të shtetasit Eduard Duka. Burime policore thanë se dyshohet se në ngjarjen e ndodhur rreth një vit më parë, Rivellino Mumajesi i dha ndihmë atentatorëve, duke qenë se ishte banor i zonës. Sakaq hetuesit sqarojnë se të plagosurit, para disa ditësh kanë bërë një sherr me dy persona, të cilët dyshohet se mund të jenë autorët. Rivellino Mumajesi, Juxhin Mumajesi, si dhe Ibrahim Durollari janë të skeduar nga policia si persona merren me shitjen dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike.

Ndërkohë menjëherë pas vendosjes së shiritit të sigurisë dhe fiksimit të provave nga grupi hetimor, janë shoqëruar në Komisariatin nr.4 rreth 23 persona të cilët janë cilësuar si dëshmitarë oku-

ARRESTIMI

I vetmi person, i cili ndodhet pas hekurave është 29-vjeçari Ervis Bano. Kjo pasi dyshohet se Bano ka marrë serverin e kamerave të një biznesi në zonën ku ndodhi ngjarja, dhe ka tentuar ta dëmtojë, për të fshehur pamjet. Ndërkohë mësohet se deri tani janë shoqëruar rreth 23 persona në ambientet e policisë, të cilët dyshohet se kanë dënuar për ngjarjen.

larë, si edhe persona të tjerë të cilët dyshohet se kanë dënuar për ngjarjen. Uniformat blu kanë ushtruar kontroll në banesat e disa prej të dyshuarve si autorë. Ndërsa pritet përmirësimi i gjendjes shëndetësore së të plagosurve për të marrë depozitat e tyre. Ende nuk dihet sesa armë janë përdorur, ndërkohë është bërë këqyrja e vendngjarjes, ndërsa është vënë në rrethim zona. Po vijon puna për identifikimin dhe kapjen e autorëve, si dhe dokumentimin e plotë të kësaj ngjar-

je. **BANORËT E ZONËS** Banorët e zonës ku ndodhi përplasja me armë zjarri të shokuar nga breshëritë e plumbave kanë lajmëruar policinë e cila mësohet të ketë mbërritur menjëherë në vendin e ngjarjes. Ata thanë se kishin dëgjuar 20 të shtëna dhe se paraprakisht kishin dëgjuar disa të rinj që ziheshin, por menduan se bëhej fjalë për ndonjë ndeshje futbolli.

Më tej banorët të tronditur treguan skenën ku ndodhi ngjarja dhe frikën që ndjenë në momentin që panë shenjat e gjakut në shkallët e jashtme në hyrje të biznesit. Sipas tyre përplasja me armë zjarri ka vijuar edhe në rrugë jashtë lokalit të bastesh. "Dëgjua rreth 20 të shtëna. Kujtuam se ishin fishkëzjarrë po kur dolëm në ballkon pamë shumë lëvizje. Para se të nisnin të shtënat dëgjua që të rinjtë po debatojnë, po menduam se ishin konflikte për ndeshjen. Kur dolëm vendi ishte mbushur me gjak dhe gëzhoja", deklaruan banorët e zonës në Kinostudio, lidhur me përplasjen me armë zjarri mes dy grupeve rivale, të cilët dyshohet se kishin konflikt për ndarjen e territorit të drogës.

SHPLLAJE ANKANDI
Datë 02.07.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbartëse "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallat "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426. Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202. e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Shpallje ankandit e pasur për pasurinë e paluajtshme të debitorit Shoqëria "VIGAND Konstruksion" sh.p.k. "Njësi" me sipërfaqe 265.22 m², nr. i pasurisë 8440-N12, zona kadastrale 8150, vol. 47, faqe 208, adresa: Rruga "Petro Nini Luarasi", Tiranë.

Çmimi llogaritur i ankandit të dytë është në shumën 339 482 (treqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e tetësheqerë e dy) EUR.

Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbartëse "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

NJOFTIM ANKANDI

Përmbartues gjyqësor privat Artan Sima zhvillon ankandit sipas datave të mëposhtme: Datë 03/07/2018, ditën e Martë, ora 16:00, përfundon ankandit i ri (i parë), për shitjen e pasurive të paluajtshme të llojit: "Apartament" me sipërfaqe prej 53,92 m², Rr "Ahmet Bektashi", pl. 59, shk. 1. k2, ap. 6, në Kolonjë, në vlerën 1.600.000 lekë.

Pasuria është lenë në garancë bankare për shlyerje kredie sipas kontrates për venien e sendit në hipoteke të debitorit z. Donika Thoma Pira, Erseke, Kolonjë, për detyrimin ndaj kreditorit z. Ylli Koco Sotiri, banues në Erseke, Kolonjë.

Ankandit zhvillohet pranë zyrës së përmbartësit me seli lagjen nr.3, Rruga "Avni Rustemi", nr.31 .k.1, Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com

NJOFTIM ANKANDI

Përmbartues gjyqësor privat Artan Sima zhvillon ankandit sipas datave të mëposhtme: Datë 04/07/2018, ditën e Mërkurë, ora 16:00, përfundon ankandit i ri (i parë), për shitjen e pasurive të paluajtshme të llojit: "Apartament" me sipërfaqe prej 82 m², e ndodhur në Korçë, në vlerën 2.099.200 lekë.

Pasuria është lenë në garancë bankare për shlyerje kredie sipas kontrates për venien e sendit në hipoteke të debitorit Z.Bashkim Ilimi Sataj banues në Korçë, për detyrimin ndaj kreditorit z. Alfred Selim Xhambazi banues në Korçë

Ankandit zhvillohet pranë zyrës së përmbartësit me seli lagjen nr.3, Rruga "Avni Rustemi", nr.31 .k.1, Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com

Pas një rritjeje të fortë vitet e fundit, eksportet e frutave dhe zarzavateve kanë pësuar rënie në 5 muajt e orare të 2018-ës. Sipas të dhënave të INSTAT, eksportet e prodhimeve bujqësore (fruta dhe zarzavate ku përfshihen edhe domatet) pësuan rënie më 3.3% për qind. Nga janar-maj u eksportuan 3.55 miliardë lekë ose 123 milionë lekë më pak. Edhe pse këtë vit kushtet klimaterike kanë qenë më favorizuese për zarzavatet dhe frutat, eksportet nuk e kanë reflektonuar këtë ecuri. Nga ana



Raporti i INSTAT për 5-mujorin

Eksportet e frutave dhe zarzavateve bien me 3.3 për qind

tjetër, për të dyja grupet importet kanë shënuar rritje në periudhën në fjalë me mbi 9 për qind në raport me 5-mujorin e 2015. Gjithsesi, u importuan 6.4 miliardë lekë fruta dhe zarzavate ose 533 milionë lekë më shumë se një vit më parë. Deficitit tregtar ishte më i lartë, pasi importet në vlerë ishin 62% më

të larta se eksportet. Sipas të dhënave zyrtare, prodhimi i perimeve gjatë vitit të kaluar ishte 1.15 milionë tonë duke shënuar rritje vjetore rreth 2% krahasuar me vitin 2016. Në vitin 2017, perimet e njoma ishin 742.522 tonë duke shënuar një rritje me 0.33% krahasuar me 2016. Prodhimi i bostanor-

eve ishte 295.670 tonë, duke shënuar rritje me 6.91% krahasuar me 2016 dhe perimet e thata 113.736 tonë duke shënuar rritje prej 1.06% në krahasim me vitin 2016. Bujqësia në Shqipëri, avatazhin e vetëm konkurrues ka klimën e ngrohtë që mundëson nxjerrjen e prodhimeve në treg një muaj para rajonit dhe kjo nuk është pak, por sektori ka kosto më të larta se në vendet e tjera për shkak të copëzimit të lartë të tokës dhe mungesës së subvencioneve. Në Maqedoni, nafta e kuqe për bujqësinë jepet me 50 lekë, ndërsa në Shqipëri, fermerët e blejnë njësoj si linjat e tjera të biznesit me çmimin e tregut, me 150-160 lekë, pa asnjë diferencë. Në Greqi dhe Maqedoni, fermerët subvencionohen direkt mbi prodhimin dhe fondet publike e mbulojnë risikun që mund të vijë nga ndryshimi i klimës ose mungesa e tregut.

Këshilli Mbikëqyrës, BSH forcon rregullat dhe kontrollet për pastrimin e parave

Ornela Manjani

Banka e Shqipërisë ka nisur kontrolle të një pasnjeshme në zyrat e këmbimit valutor për shkak të informalitetit të lartë që ka ky lloj biznesi dhe raportimeve problematike që ata bëjnë në sistemin për këmbimin e valutave. Banka Qendrore bën me dije se shumë pika të këmbimit valutor rezultojnë me risk të lartë në fushën e pastrimit të parave, ndërsa në vitin 2017-ë Departamenti i Mbikëqyrjes ka revokuar 41 licenca të këtyre zyrave, nga 8 që ishte numri i licencave të hequra në vitin 2016. Në total në vitin 2017 në territorin shqiptar operuan 426 zyra të këmbimit valutor, ku 10% e tyre janë pezulluar.

KONTROLLET

Kontrollet janë përqendruar edhe në institucionet financiare ku 29 subjekte, mes tyre 4 banka, kanë rezultuar me risk të lartë. "Shkak për këtë - thotë Banka Qendrore - është bërë mosraportimi i transakcioneve". Problematikat më të përhapura lidhen me justifikimin e transfertave bankare të kryera nga punonjësit e bankave, disponimin

Hiqen 41 licenca të pikave të këmbimit valutor

Nisin kontrollet në katër banka



e dokumenteve që provojnë burimin e fondeve apo identifikimin e saktë të strukturës së pronësisë së bizneseve. Mësohet se Banka Qendrore është duke përgatitur edhe një rregullore të re

lidhur me forcimin e marrëdhënies që kanë zyrat e këmbimit valutor me institucionet bankare dhe raportimin e saktë të transakcioneve që do të bëjnë me njëra-tjetrën.

RREGULLAT E REJA

Banka e Shqipërisë ka forcur rregullat që lidhen me mbikëqyrjen e tregut, duke bërë ndryshimet e nevojshme në rregulloren për parandalimin e pastrimit

PROBLEMATIKA

Problematikat më të përhapura lidhen me justifikimin e transfertave bankare të kryera nga punonjësit e bankave, disponimin e dokumenteve që provojnë burimin e fondeve apo identifikimin e saktë të strukturës së pronësisë së bizneseve.

it të parave. Fokusi i ndryshimeve ka të bëjë me përfshirjen në raportim të të gjithë subjekteve edhe pranë Bankës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë pret që edhe gjatë këtij viti ndryshimet

në sistemin bankar të lidhura me shitjen apo bashkimin e bankave të vijojë duke sjellë si efekt në fund të vitit më pak banka në strukturën e përgjithshme të tregut. Të gjitha këto detaje u bënë me dije gjatë prezantimit të Raportit të Mbikëqyrjes të vitit 2017 të Bankës së Shqipërisë. Mes të tjerave, ky institucion ka vënë theksin te prioritetet që do të ketë gjatë vitit 2018 të lidhura me rrezikun e kreditit me fokus kreditet me probleme dhe trajtimin e kredimarrësve në vështirësi financiare. Po kështu, përafrimi i mëtejshëm i kuartrit rregullator me Bazel III dhe finalizimi i projektit për rregullimin dhe mbikëqyrjen e qeverisjes së bankave. Në fokus do të jetë edhe konsolidimi i sistemit bankar, vetëvlerësimi ekuivalencës së kuartrit rregullativ me direktivat europiane si dhe bashkëpunimi me Bankën Qendrore Europiane (nënshkrimi i marrëveshjes bilaterale të bashkëpunimit) apo monitorimi i efekteve nga standardet e reja të raportimit financiar përgatitja e raportimit financiar sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit).

TENDERA NË "TAVOLINË"

APP gjobit 110 punonjës, shkelje në 20 procedura prokurimi

Rreth 110 punonjës janë gjobitur nga Agjencia e Prokurimit Publik, pasi janë gjetur në shkelje të dispozitave ligjore të prokurimit. APP ka ndërmarrë një hetim administrativ në fokus të cilin ishin 20 procedura prokurimi të kryera me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, zhvilluar nga 20 institucione të ndryshme. Ky dikaster ka konstatuar një sërë shkeljesh të kryera, duke filluar me përzgjedhjen e kësaj procedure në kundërshtim me ligjin. Po ashtu, rezultatet e autoritetit kontraktore e arsyetojnë kryerjen e këtyre lloj procedurave me faktin se ndodhen në kushte të nevojës ekstreme, por më së shumti nuk i justifikojnë rrethanat që i kanë çuar në pamundësi për të planifikuar në kohë nevojat e tyre. Po ashtu, në 3 raste është konstatuar se kjo lloj procedure është përdorur si shtesë kontrate për punë publike që nuk kanë qenë të përfshira në kontratën fillestare. Gjithashtu, në procedurat e verifikuara është evidentuar gjërësisht mungesa e argumentimit të kritereve të veçanta të pranimit dhe përcaktimi i kritereve jo në raport me natyrën dhe përmasat e kontratës. Sipas legjislationit, shkeljet administrative të kryera në këto raste gjobiten me vlera 50-100 mijë lekë, ndërkohë që për 12 punonjës APP ka propozuar edhe marrjen e masës disiplinore.

Rëndohen financat e OSHEE-së

ERE rrëzon ankesën e 'Operatorit' mbi korrigjimin e faturave



Energjisë të lidhur në rrjetin e transmetimit dhe atë të shpërndarjes, të cilët nuk janë subjekt i disbalancave, por të gjithë energjinë e prodhuar kanë të drejtë ta

shesin tek OSHEE. Sipas një tabelë ilustruese të paraqitur në herët nga OST, evidentoheshin disbalanca artificiale pozitive, ku realisht OSHEE nuk kishte injektu-

ar fizikisht energji në rrjet, duke i krijuar KESH-it diferenca në bilancin financiar. Sipas kësaj tablele, realisht "OSHEE" krijon disbalanca negative dhe ka pasur detyrimin që këto disbalanca t'ia paguajë KESH. Praktikisht, ERE ka lënë në fuqi vendimin e muajit maj, i cili përcakton se impakti financiar që do të vijë nga korrigjimi i faturave do të reflektohet tek OSHEE, ndërsa shumë gjasa kjo do të pasohet me më pak investime në rrjet, që do të sillte përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve.

Paketa fiskale, zbritja për bizneset me të ardhura deri në 14 milionë lekë

Ornela Manjani

Ulja e tatimfitimit nga 15 në 5%, bizneset që përfitojnë

Ndikimi në arkën e shtetit nga ulja e taksave

Ndryshimet e fundit që Këshilli i Ministrave ka ndërmarrë në paketën fiskale duke ulur tatimfitimin nga 15 në 5% për fermerët që bashkohen në kooperativa, për bizneset e agroturizmit e ulja e tatimfitimit për bizneset me të ardhura deri në 14 milionë lekë pritet të ketë një efekt në zërin e të ardhurave në buxhetin e shtetit. Ndikimin më të madh pritet ta ketë vendimi për tatimin e fitimit në 5% (nga 15 që është aktualisht) edhe për bizneset me të ardhura nga 8 deri në 14 milionë lekë. "Rritja e pragut nga 8 milionë në 14 milionë ka efekt -420 milionë lekë në grupin e tatimpaguesve që aktualisht taten me shkallë tatimi mbi fitimin 15%. Ndërkohë, ky ndryshim do të ketë efekt pozitiv si rezultat i rritjes së vetëdeklarimit nga tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të cilët do taten me shkallë tatimi 5% edhe për segmentin tatimpaguesve me një qarkullim vjetor prej 8-14 milionë lekësh. Efekti pozitiv i vlerësuar nga ky grup llogaritet në rreth +200 milionë lekë", shkruhet në relacion. Reduktimi i normës së tatimit mbi fitimin për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor nga 15% në 5% nuk do të shoqërohet me reduktim të ardhurash në buxhet, pasi aktualisht numri i SHBB-ve të regjistruara ka qenë minimal (30 të tilla), ndërkohë që kontributi fiskal në buxhet ka qenë i papërfillshëm. "Pritet që rritja e numrit të SHBB-ve dhe e vullmit të punës së tyre do të çojë në rritjen e të ardhurave dhe rrjedhimisht edhe të kontributit fiskal", vijon relacioni. Po ashtu, reduktimi i normës së tatimit mbi fitimin për sektorin e agroturizmit nga 15% në 5% nuk do të shoqërohet me reduktim të ardhurash në buxhet, pasi numri i njësive agroturistike është minimal dhe pjesa më e madhe e tyre janë të regjistruara si biznes i vogël. "Parashikohen efekte pozitive që nuk mund të maten nga zgjerimi ekstensiv i këtij biznesi si rezultat i incentivave të ndërmarrura", vijon relacioni.

BUJQËSIA
Sektori i bujqësisë përbën një ndër sektorët bazë të ekonomisë shqiptare. Zhvillimi dhe modernizimi i tij do të ketë impakt edhe në sektor të tjerë prioritarë për vendin, sikurse është industria e turizmit, e cila e ka të nevojshme bashkëpunimin me një sistem bujqësor, që është në gjendje të garantojë furnizimin me produkte bujqësore dhe blegtorale në sasi, cilësi dhe kohë. Ndërkohë, një sektor bujqësor i kompozuar nga fermerë individualë me ngastra të vogla toke dhe prodhim



Gjatë një mbledhjeje të qeverisë

NDRYSHIMI

"Rritja e pragut nga 8 milionë në 14 milionë ka efekt -420 milionë lekë në grupin e tatimpaguesve që aktualisht taten me shkallë tatimi mbi fitimin 15%".

minimal për treg nuk është në gjendje të plotësojë kërkesat e konsumatorëve dhe për më tepër, ato të një industrie siç është turizmi. Gjithashtu, është e vështirë që

prodhuesit individualë të jenë faktor i rëndësishëm për rritjen e eksporteve të produkteve bujqësore. Për këto arsye, është e domosdoshme të rritet shkalla

Bizneset e vogla

Bizneset e vogla ngurojnë për të deklaruar xhiron breale, pasi nëse kjo xhiro është 7,9 milionë, ky biznes paguan 5% tatim mbi fitimin neto të tij dhe nëse xhironja e tij do të rritet në 8,1 milionë, ai paguan jo 5%, por tri herë më shumë, 15% tatim mbi fitimin. Pikërisht, për të shmangur këtë problem, po prezantojmë rishikimin e pragut dhe të ngarkesës fiskale të tatimit mbi fitimin për biznesin e vogël, duke synuar që pragu 8 milionë lekë të rritet në një kufi të arsyeshëm 14 milionë lekë në vit. Gjithashtu, ky propozim synon të lehtësojë ngarkesën fiskale për një numër të konsiderueshëm tatimpaguesish, afërsisht 10.800, që aktualisht bëjnë pjesë në kategorinë me të ardhura mbi 8 milionë dhe i nënshtrohen shkallës së tatim-fitimit 15%. Referuar parashikimeve të propozuara tatimpaguesit me të ardhura vjetore deri në 14 000 000 lekë do t'i nënshtrohen një shkalle tatimfitimi prej 5%. Pra, në tërësi synohet të lehtësohet kategoria e biznesit të mesëm.



kërkon edhe stimuj nxitjes. Në këtë kuptim, krahas masave të tjera nxitëse të sektorit bujqësor sikurse janë subvencionimet, investimet në kullim, ujtje etj.,

është e arsyeshme që nxitjes së kooperimit dhe krijimit të njësive të mëdha prodhuese bujqësore t'i shërbejë edhe një normë tatimi mbi fitimin e reduktuar për këto shoqëri. Gjithashtu, edhe vendet e tjera të rajonit përdorin incentiva dhe mekanizma të ndryshëm, me qëllim stimulimin e produkteve bujqësore të prodhuara dhe konsolidimin e prodhuesve vendës.

AGROTURIZIMI

Në kuadrin e mbështetjes dhe stimulimit të sektorëve dhe industrive prioritare të vendit, sektori i agroturizmit do të jetë gjithashtu një ndër prioritetet e vendit, me qëllim zhvillimin e turizmit në zonat rurale, e shoqëruar kjo me nxitjen e prodhimit dhe tregtimit të produkteve lokale të zonës. Parë në këtë këndvështrim, iniciativa e ndërmarrë synon të nxitë krijimin dhe rritjen e këtij biznesi, i cili pritet të ofrojë akomodim, ushqim, çlodhje, argëtim dhe veprimtari të tjera të lidhura me fermën bujqësore. Projektligji parashikon për këtë kategori biznesesh normë të reduktuar të tatimit mbi fitimin prej 5%. Legjislacioni i fushës së turizmit ka parashikuar agroturizmin si kategori të veçantë të tij, ndërkohë që vendimi i Këshillit të Ministrave ka përcaktuar kriteret për licencimin e operatorëve "agroturistikë". Norma e reduktuar e tatimit mbi 2 fitimin 5% për këtë sektor shoqërohet gjithashtu me incentiva lidhur me normën e reduktuar të TVSH-së dhe përjashtimin nga taksat e ndikimit në infrastrukturë.

Subjektet do paguajnë 420 milionë lekë më pak

Me rritjen e pragut nga 8 milionë në 14 milionë do të paguajnë 420 milionë lekë më pak grupi i tatimpaguesve që aktualisht taten me shkallë tatimi mbi fitimin 15%. Ndërkohë, ky ndryshim do të ketë efekt pozitiv si rezultat i rritjes së vetëdeklarimit nga tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të cilët do taten me shkallë tatimi 5% edhe për segmentin tatimpaguesve me një qarkullim vjetor prej 8-14 milionë lekësh. Efekti pozitiv i vlerësuar nga ky grup llogaritet në rreth +200 milionë lekë. Reduktimi i normës së tatimit mbi fitimin për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor nga 15% në 5% nuk do të shoqërohet me reduktim të ardhurash në buxhet, pasi aktualisht

NDRYSHIMET E SHKALLËS SË TATIMIT

- **Shkalla e tatimit mbi fitimin**
5% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit.
15% për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 000 000 lekë në vit.
- **Shkalla e tatimit për pronat e paluajtshme**
Fitimi kapital i realizuar si rezultat i kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, në normën 15 për qind.
- **Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor**
Shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%. Për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit Shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%.
- **Tatimi mbi lojërat e fatit**
Shkalla e tatimit 15% mbi të ardhurat bruto. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar Shkalla e reduktuar e Tatimit mbi Vlerën e shtuar 6 për qind aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit, restorantit.



numri i SHBB-ve të regjistruara ka qenë minimal (30 të tilla), ndërkohë që kontributi fiskal në buxhet ka qenë i papërfillshëm. Pritet që rritja e numrit të SHBB-ve dhe e vullmit të punës së tyre do të çojë në rritjen e të ardhurave dhe rrjedhimisht edhe të kontributit fiskal. Reduktimi i normës së tatimit mbi fitimin për sektor-

in e agroturizmit nga 15% në 5% nuk do të shoqërohet me reduktim të ardhurash në buxhet, pasi numri i njësive agroturistike është minimal dhe pjesa më e madhe e tyre janë të regjistruara si biznes i vogël. Parashikohen efekte pozitive, që nuk mund të maten nga zgjerimi ekstensiv i këtij biznesi si rezultat i incentivave të ndërmarrura.

PUNONJËSIT E BUJQËSISË SIGURIMI

Voltiza Duro

Instituti i Sigurimeve Shoqërore iu ka bërë thirrje sërish të gjithë fermerëve që të sigurohen si të vetëpunësuar në bujqësi. "Fermerë, që ushtroni aktivitetet bujqësore e blegtorale: Vazhdoni të siguroheni në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore si të vetëpunësuar në bujqësi. Mos qëndroni indiferentë për të ardhmen tuaj. Është në të mirën tuaj dhe të familjes suaj"-theksohet në njoftimin e ISSH-së. Kështu nga ky sigurim fermerët mund të përfitojnë pension, vizita mjekësore pa pagesë si dhe kompensimin e çmimit të barnave në rast sëmundjesh. Respektivisht punonjësit e bujqësisë e blegtorisë mund të marrin pension pleqërie; pension invaliditeti; pension familjar për fëmijët; sigurim për barrëindjen për nënat e reja; vizitën mjekësore pa pagesë dhe kompensimin e çmimit të barnave mjekësore në rast sëmundjeje.

KRITERET DHE PAGESAT

Sipas ligjit, individit që hyn në skemën e detyruar të sigurimit shoqëror për t'u siguruar si i/e vetëpunësuar në bujqësi, duhet të plotësojë disa kriteret. Kështu ai duhet të ketë mbushur moshën 16 vjeç; të jetë i/e aftë për punë; dhe të mos jetë i siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë. Gjithashtu, i vetëpunësuar në bujqësi duhet të banojë në të njëjtin rreth ku ka tokën bujqësore në pronësi ose në përdorim, dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore e blegtorale. Por ai edhe mund të banojë në fshat dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore dhe blegtorale, megjithëse tokën mund ta ketë në rrethin

"Barnat me rimbursim, sa ju takon nga kompensimi. Masa e kontributeve që duhet të derdhi"

Sigurimi i fermerëve, ISSH: Ja çfarë mund të përfitoni

"Merrni pension pleqërie dhe vizita pa pagesë"



Foto ilustruese

PËRFITIMET

Nga ky sigurim fermerët mund të përfitojnë pension, vizita mjekësore pa pagesë si dhe kompensimin e çmimit të barnave në rast sëmundjesh. Respektivisht punonjësit e bujqësisë e blegtorisë mund të marrin pension pleqërie; pension invaliditeti; pension familjar për fëmijët; sigurim për barrëindjen për nënat e reja; vizitën mjekësore pa pagesë dhe kompensimin e çmimit të barnave mjekësore në rast

fquinjë. Vlen të theksohet se ka të drejtë të sigurohet çdo person deri në mbushjen e moshës për të dalë në pension. Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën me dije se sigurimi si i/e

vetëpunësuar në bujqësi është i detyrueshëm dhe ky i/e vetëpunësuar/a, që banon në zonat fushore, duke filluar nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor; të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 38 400 lekësh. "Nërkohë, i/e vetëpunësuar/a në bujqësi, që banon në zonat malore, nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor; të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 29 400 lekësh",-thekson ISSH. Sakaq, afati i fundit i këtyre pagesave është jo më

29400

LEKË KONTRIBUTI I DERDHUR

"Nërkohë, i/e vetëpunësuar/a në bujqësi, që banon në zonat malore, nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 29 400 lekësh",-thekson ISSH.

38400

LEKË DETYRIMET


ISSH bën me dije se sigurimi si i/e vetëpunësuar në bujqësi është i detyrueshëm dhe ky i/e vetëpunësuar/a, që banon në zonat fushore, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor; të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 38 400 lekësh.

tur mbi bazën e masës vjetore prej 29 400 lekësh. Pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhen bashkërisht. Ato janë të detyrueshme dhe paguhen individualisht një herë në tre muaj",-thekson ISSH. Sakaq, afati i fundit i këtyre pagesave është jo më

vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendari. Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për vitin në vazhdim, pavarësisht nëse janë të pasiguruar për vitet pararendëse.

Takimi, pasojat e internetit te fëmijët dhe të rinjtë

Ditën e djeshme, COD Organizoi tryezën e diskutimit me temë "Pasojat e internetit te të rinjtë dhe fëmijët". Kjo tryezë bëri bashkë partnerë të ndryshëm që punojnë në këtë drejtim, përfshirë këtu institucione shtetërore dhe organizata ndërkombëtare e joqeveritare. Takimi u drejtua nga zëvendësmministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Ardjana Jaku e pjesë e panelit ishin lektorët Prof. Dr. Lek Sokoli, Dr. Skerdi Sahaj, Mergit Vataj, Drejtori i "Alo116" dhe përfaqësuesja e AKCESK, Edlira Gjollshii. Të pranishmit evidencuan nevojën për



përpunimin dhe analizën e të dhënave konkrete e të përditësuara që të adresojnë periodikisht këtë problematikë. Po kështu, nevojën për plotësimin dhe rregullimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve dhe rritjen e sigurisë online, forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit e të gjithë aktorëve në këtë përpjekje të

përbashkët, si dhe bashkëpunimin për kalimin e rasteve konkrete të evidentuara nga organizatat tek institucionet shtetërore dhe anasjelltas. Ndërgjegjësimi dhe informimi i të rinjve si dhe prindërve për denoncimin e çdo fenomeni që lidhet me rrezikun që vjen nga përdorimi i teknologjisë së informacionit ishte një tjetër pikë, e cila u diskutua në këtë tryezë. Rekomandimet do të reflektohen edhe në strategjinë e veprimit të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, (AKCESK) që do të miratohet së shpejti.

EPSA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"
SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

- 1- "Pyll + Kullote" me sip. 280.000 m2, Nr. hipotekor 168 date 29.05.2012, ZK 3028, e ndodhur në Poro, Vlore. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **4.800.320 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- 2- "Pyll + Kullote" me sip. 95.000 m2, Nr. hipotekor 66 date 25.03.2009, ZK 3028, e ndodhur në Poro, Vlore. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **1.628.680 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- 3- "Truall + Ndërtim" me sip.3,250 m2 nga kjo 1474,5 m2 ndërtesë me adresë Xhafzotaj, Durrës. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **545.440 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- 4- **Për pasurinë** me Nr.578/184, vol.13, fq.216, Zk.3385, me sip.1,270 m2 me adresë Shkallnur, Durrës. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **35.560 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane
- 5- **Për pasurinë** me Nr.1/973+1-9, vol.41, fq.85, Zk.8513, me sip.119,2 me adresë Rr."Muco/15", Durrës. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **40.040 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane
- 6- **Për pasurinë** me Nr.160/51, vol.16, fq.72, Zk.2574, me sip.2.470 m2 me adresë Xhafzotaj, Durrës. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **138.320 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane
- 7- **Për pasurinë** me Nr.160/50, vol.6, fq.71, Zk.2574, truall + ndërtesë me sip.7,330 m2 me adresë Xhafzotaj, Durrës. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **941.360 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

Klosi: Prej 1 korrikut, kontrole të rrepta në plazhe

Tolerancë zero ndaj subjekteve që shkaktojnë ndotje akustike në sezonin turistik

Prej datës 1 korrik të këtij viti, toleranca ndaj subjekteve që shkaktojnë ndotje akustike dhe shkelin ligjet do të jetë zero. Paralajmërimi ka ardhur nga ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi ditën e djeshme gjatë takimit të Komitetit Rajonal të Turizmit në qarkun e Durrësit. Në fjalën e tij, Klosi theksoi se nuk do të ketë asnjë negociim për ata që shkelin zonat e përcaktuara për mjete lundruese, për subjektet që nuk kanë rojet e plazhit, por edhe për lokalet, apo baret që sh-

kaktojnë ndotje akustike dhe shkelin rregullat e vendosura nga bashkia. "Eshhtë parimore, thelbësore, psikologjike, është shumë e nevojshme që të kemi nga 1 korrik zbatim të ligjit dhe këtu bashkia ka detyrën kryesore pasi zonat janë dhënë nga bashkia me qira në përdorim të biznesit, por kontrolli duhet të jetë i superorgani- zuar në radhë të parë nga bashkia, nga Inspektorati i Mjedisit dhe Turizmit dhe

padyshim edhe nga forcat e tjera ligjzbatuese", tha kreu i Turizmit e Mjedisit gjatë takimit. Ky i fundit më tej u ndal edhe në 3 detyrat kryesore të institucioneve të angazhuara në mbarëvajtjen e sezonit turistik: garantimi maksimal i pastërtisë, siguria në plazhe dhe rritja e standardeve të mikpritjes. "Kemi shumë nevojë që ato 3 detyrat kryesore që i kemi vënë vetes për sezonin turistik janë garantimi

maksimal i pastërtisë dhe këtu nuk bëhet fjalë vetëm për pastërtinë nga punonjësit e bashkisë, nga stafi i bashkisë për pastrimin e mbetjeve urbane. Ajo duhet të jetë e padiskutueshme", nënvizoi Klosi. Në takimin e mbajtur në prefekturën e Durrësit, bashkë me ministrat e përfaqësues të pushtetit lokal, ishin të pranishëm edhe përfaqësues nga biznesi i turizmit. Ndërkohë ministri i Bujqësisë dhe Zhvil-



limit Rural, Niko Peleshi theksoi se sfida e këtij sezoni është siguria ushqimore për të cilën ai tha se është forcuar inspektimi, i paraprirë nga vetëkontrolli i subjekteve. Ndërsa Min-

istri Majko kërkoi nga Task Forca e turizmit që të merren të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë pa shqetësuar turistët vendas dhe të huaj. Vo.Du.

Sa kohë mund të qëndroni në tokën e premtuar, penalizime të rënda për shkelësit e afatit

Ambasada: Vizat turistike në SHBA, vendimi bazohet tek intervista

Ekspertët: Kujdes, çfarë duhet t'i shpjegoni konsullit

Të interesuarit që kanë në plan të shkojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të bëjnë kujdes ditën e intervistës me konsullin dhe të shpjegojnë sa më qartë planet e udhëtimit. Ditën e djeshme, ambasada amerikane në Tiranë, nëpërmjet një njoftimi në faqen e saj zyrtare ka bërë me dije se procesi i vizave turistike përqendrohet tek intervista, dhe jo te dokumentacioni që dorëzohet. "Po planifikoni të vizitoni Shtetet e Bashkuara? Nuk ka nevojë të sillni shumë dokumente shtesë në intervistën tuaj. Procesi i vizave të Shteteve të Bashkuara përqendrohet tek intervista. Për t'u përgatitur sa më mirë shpjegoni planet tuaja të udhëtimit, lidhjet në vendin tuaj dhe përgjigjuni disa pyetjeve. E jani të përgatitur për të biseduar me ne rreth planeve tuaja të udhëtimit dhe lërimi dokumentet në shtë-



pi!", thekson ambasada. **KOHA E QËNDRIMIT NË SHBA**
Të gjithë aplikantët duhet të kenë parasysh që viza turistike ka për qëllim një qëndrim për një kohë të shkurtër në SHBA e nuk jepet për të jetuar në SHBA dhe as për të punuar atje. "Ju mund të gjendeni i papranueshëm sipas ligjit të imigracionit. Në përgjithësi, ju duhet të qëndroni për aq kohë sa ju keni deklaruar në aplikimin tuaj për vizë. Gjithashtu, brenda

një viti nuk mund të qëndroni më shumë se gjashtë muaj në total, ose edhe më pak, sipas autorizimit nga oficeri i imigracionit", theksojnë ekspertët e ambasadës. Kështu me vizë turistike është e ndaluar puna në SHBA. Nëse oficeri i imigracionit ngre dyshime që qëllimi i vizitës së individit nuk është turistik, por për punë, atij mund t'i revokohet viza. Për shumicën e mbajtësve të vizave të vizitorit (B1/B2), koha maksimale e qëndrimit është në

përgjithësi gjashtë muaj në një vit kohor. Studentët, vizitorët e programeve të shkëmbimit dhe punëtorët e përkohshëm janë në përgjithësi të pranuar për kohëzgjatjen e statusit. Pavarësisht nga kjo, për të shmangur në të ardhmen problemet me vizën apo me hyrjen në Shtetet e Bashkuara, qëllimi dhe koha e qëndrimit në Shtetet e Bashkuara duhet të jetë në përputhje me çfarë kandidati ka thënë në aplikimin për vizë.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje dhe implementim i 4 copë pajisje 'SAN Switch' për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 27.000.000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfuttesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje dhe implementim i 4 copë pajisjeve 'SAN Switch' për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 25 Korrik 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR NDERKOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Upgrade i Sistemit të Regjistrimit të Kredive të Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur ndërkombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 30.000.000 Lekë ose 226,655 Euro".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfuttesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Upgrade i sistemit të Regjistrimit të Kredive të Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 26 Korrik 2018, ora 09:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

STUDIMET NË ITALI

INTERVISTA

Drejtesja e patronatit INAS Albania: Dokumentacioni i plotë që duhet të dorëzoni

Hapet faza e dytë e aplikimit për studime në Itali

Beskida Aliaj: Sa para duhet të ketë studenti në llogarinë bankare

Voltiza Duro

Dje është çelur faza e dytë e aplikimeve për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të ndjekin një program studimi Bachelor, Master apo Doktoraturë në Itali. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", drejtesja e patronatit INAS Albania, Beskida Aliaj tregon të gjitha hapet që duhet të ndjekin aplikantët për t'u shpallur fitues si dhe dokumentacionin e plotë që duhet të paraqesin. Studentët duhet të dinë se kërkohet një llogari rrjedhëse personale e hapur në një bankë italiane e pranishme në Shqipëri, që vërteton zotërimin nga ana e aplikantit, të një shume minimale prej 5890 euro/vit. Gjithashtu, kandidatëve iu kërkohet edhe një deklaratë për vendbanimin në Itali, sigurimi shëndetësor si dhe certifikimi i njohjes së gjuhës italiane të një niveli jo më të ulët se B2.

Çilat janë hapet që duhet të ndjekin studentët në fazën e dytë të aplikimit për të studiuar në Itali?

Studentët që i përkasin juridiksionit të Zyrës Konsullore të ambasadës italiane në Tiranë dhe kanë aplikuar për regjistrim universitar në Zyrën Konsullore mund të aplikojnë për një vizë studimi "në regjistrimin universitar" duke lënë takim me Zyrën e Vizave, nëpërmjet prenoto Online, duke filluar nga data 1 gusht 2018.

A ndryshon procedura për ata që aplikojnë për degë me numër të mbyllur?

Studentët që dëshirojnë të regjistrohen "Në degët me numër të mbyllur" mund të paraqesin kërkesën për vizë vetëm në momentin që e kanë kaluar testin e pranimit. Për ta marrë këtë provim, studentët me shtetësi shqiptare do të mund të shkojnë në Itali pa vizë. Studentët duhet të prezantojnë në momentin që bëjnë kërkesën për vizë një vërtetim të lëshuar nga vetë universiteti i përzgjedhur që tashmë janë pranuar nga universiteti.

Cili është dokumentacioni që duhet të paraqesin



Drejtesja e patronatit INAS Albania, Beskida Aliaj.



DOKUMENTACIONI

- 1) Formulari për kërkesën e vizës, i plotësuar saktë
- 2) Pasaportë e vlefshme
- 3) Kopje e faqes se pasaportës me të dhënat personale;
- 4) 2 fotografi me ngjyra për dokument të kohëve të fundit
- 5) Certifikatë lindjeje;
- 6) Deklaratë vlefshmërie të titujve të studimit të marra , të përshtatshme për regjistrim në universitet italiane
- 7) Deklaratë mbi të dhënat personale;
- 8) Deklaratë për vendbanimin në Itali;
- 9) Sigurimi shëndetësor;
- 10) Mjete ekonomike : llogari rrjedhëse personale e hapur në një bankë italiane e pranishme në Shqipëri;
- 11) Disponibilitet të shumes se nevojshme për riatdhesim (me avion rreth 200 euro) i provueshem dhe me paraqitjen e biletes se kthimit.
- 12) Certifikimi i njohjes së gjuhës italiane të një niveli jo më të ulët se B2 (i nevojshëm vetëm për kurset në gjuhën italiane).
- 13) Deklaratë e lëshuar nga Universiteti i përzgjedhur që vërteton kalimin e (vetëm për degët me numër të mbyllur)
- 14) Deklaratë që përjashtohet nga testet e pranimit të Bachelor ose Master e lëshuar nga Universiteti (vetëm për degët me hyrje të lirë)
- 15) Mbrojtje e përshtatshme për nxënësin e mitur

in kandidatët?

Kandidatët duhet të paraqesin formularin për kërkesën e vizës, të plotësuar saktë në çdo faqe të tij dhe të firmoset në sportel. Gjithashtu, kërkohet: një pasaportë e vlefshme me afat skadence të paktën tre muaj nga afati i skadencës së vizës së kërkuar; një kopje e faqes së pasaportës me të dhënat personale; 2 fotografi me ngjyra për dokument të kohëve të fundit si dhe një certifikatë lindjeje (modeli shumëgjuhësh) e apostiluar, nëse tash-

më nuk është dorëzuar gjatë fazës së para-regjistrimit. Të interesuarit duhet të paraqesin edhe një deklaratë vlefshmërie të titujve të studimit të marra, të përshtatshme për regjistrim në universitetet italiane (nëse nuk janë dorëzuar tashmë në fazën e para-regjistrimit) si dhe një deklaratë mbi të dhënat personale, e plotësuar saktë dhe e firmosur nga student.

A është e nevojshme të dorëzohet një vërtetim mbi vendbanimin në Itali?

5890

EURO NË VIT LLOGARIA E STUDENTIT

"Kërkohet një llogari rrjedhëse personale e hapur në një bankë italiane e pranishme në Shqipëri, që vërteton zotërimin nga ana e studentit, të një shume minimale prej 5890 euro/vit", thekson Aliaj.

1

GUSHT 2018 AFATI

"Studentët mund të aplikojnë për një vizë studimi "në regjistrimin universitar" duke lënë takim me Zyrën e Vizave, nëpërmjet prenoto Online, duke filluar nga data 1 gusht 2018", thotë drejtesja e INAS Albania.

Kërkohet një deklaratë për vendbanimin në Itali e në rast qëndrimi pranë një personi privat kërkohet një deklaratë strehimi; fotokopje e një dokumenti identiteti me firmë nga pritësi. Ndërsa në rast qëndrimi pranë enteve apo institucioneve fetare duhet një deklaratë strehimi nga enti mikpritës me fotokopje të dokumentit të identitetit me firmë të ftuesit. Sakaq, në rast qëndrimi në hotel ose pension duhet një prenotim hoteli për qëndrim jo më të shkurtër se një muaj.

Si mund ta bëjnë studentët sigurimin shëndetësor?

Sigurimi shëndetësor mund të bëhet pranë shqiptarëve të sigurimitit si shqiptare ashtu dhe italiane, për periudhën e vitit akademik 2018-2019. Në rast të sigurimitit shqiptar, nuk duhet të përmbajë në asnjë rast

kufizime ose përjashtime të asnjë lloji (as për sëmundjet e mbuluara nga siguracioni as për sa i përket tarifave të përcaktuara për një shtrim spitalor urgjent) i vlefshëm për gjithë kohëzgjatjen e saj. **Sa lekë duhet të kenë kandidatët në llogarinë e tyre bankare në mënyrë që mos hasin problem gjatë aplikimit?**

Kërkohet një llogari rrjedhëse personale e hapur në një bankë italiane e pranishme në Shqipëri, që vërteton zotërimin nga ana e studentit, të burimeve financiare të vendosura nga rregullorja MIUR (me një shumë minimale prej 5890 euro/vit), që i referohet drejtpërdrejt studentit. Për demonstrimin e kësaj kërkesë nuk është e përshtatshme shfaqja e parave kesh ose garancie ekonomike të ofruara nga personat që nuk i përkasin bërthamës familjare, ose

nëpërmjet një garancie bankare. Kërkohet ndër të tjera edhe dokumentacioni tjetër; i apostiluar dhe i përkthyer në gjuhën italiane, që vërteton gjendjen ekonomike të përgjithshme të familjes (vërtetime pune të anëtarëve të familjes, vërtetime mbi pronat, mbi të ardhurat).

Cili nivel i gjuhës italiane duhet të jetë i mbrojtur e i certifikuar nga ana e aplikantëve?

Aplikantëve iu nevojitet certifikimi i njohjes së gjuhës italiane të një niveli jo më të ulët se B2 (i nevojshëm vetëm për kurset në gjuhën italiane). Studentët që duan të regjistrohen në degët që zhvillohen në gjuhë huaj (anglisht), është e nevojshme të paraqesin një certifikatë njohjes së asaj gjuhe. Vlen të theksoj se duhet edhe një deklaratë e lëshuar nga Universiteti i përzgjedhur që vërteton kalimin e (vetëm për degët me numër të mbyllur) si dhe një deklaratë që student përjashtohet nga testet e pranimit të Bachelor ose Master e lëshuar nga universiteti (vetëm për degët me hyrje të lirë).

Po të interesuarit për Master apo doktoraturë në Itali, si duhet të procedojnë?

Për regjistrimin në programet Master universitar dhe doktoraturë, aplikantët paraqesin kërkesën drejtpërdrejt në universitetet sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në Rregulloren e secilit universitet. Pas kërkesës së pranimit, aplikantët kërkohen vizë hyrjeje për qëllime studimi. Dokumentacioni i kërkuar është i njëjtë por kërkesës prej 5,890 i shtohet shumat totale e kurset të studimit.

Avokati Hazizaj kërkoi përjashtimin e trupës gjyquese, shtyhet procesi më 2 korrik

I akuzoi për njëanshmëri, gjykatësi Artan Lazaj vë me shpatulla pas murit KPK

Klodiana Lala

TIRANË

Artan Lazaj, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe njëherazi kandidat për Këshillin e Lartë Gjyqësor, ka vënë dje me shpatulla pas murit Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Ai ishte ftuar për të dhënë shpjegimet e tij në seancë dëgjimore publike, por ndryshe nga sa pritej, gjykatësi i karrierës e detyroi trupën gjyquese të shtyjë procesin, pas kërkesës që bëri për përjashtimin e saj. Debatimi procedural mes palëve nisi menjëherë, pasi kryesuesja e seancës, Brunilda Bekteshi deklaroi se hetimi për gjykatësin kish të përfunduar vetëm për një nga tre komponentët, atë të pasurisë. "Kjo trupë gjyquese ka vendosur të përfundojë procesin e rivlerësimit bazuar vetëm në një kriter, atë të pasurisë, duke mos vendosur në këtë mënyrë mbi kriterin e figurës dhe atë profesional", deklaroi Brunilda Bekteshi. Kaq mjaftoi që avokati Sokol Hazizaj t'i kërkonte trupës të tërhiqej dhe ta thërriste të mbrojturin prej tij në seancë, pasi të kishte përfunduar hetimin në të tria kriteret; atë të pasurisë, figurën morale dhe atë të aftësisë profesionale. "Neni Q i Kushtetutës e parashikon vlerësimin tredimensional të subjektit të rivlerësimit që është integriteti, pasuria dhe profesionalizmi dhe pastaj është e drejta e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të marrë vendim, qoftë edhe bazuar në një. E drejta për një proces të rregullt ligjor është e drejta e parashikuar jo vetëm nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, por është e parashikuar edhe nga Konventat Europiane", deklaroi Hazizaj. E gjendur për herë të parë përballë një kërkesë të tillë, trupa u tërhoq në dhomën e këshillimit. 15 minuta më pas shpallën verdiktin e ndërmjetëm, duke e konsideruar të pabazuar pretendimin e avokatit Hazizaj. Ky i fundit nuk u ndal. I gjendur në krahun e djathtë të Artan Lazajt, i cili miratoi gjithçka në heshtje, avokati kërkoi përjashtimin e trupës gjyquese, të cilën e akuzoi për njëanshmëri në vendimarrje. Trupa, duket se nuk pati asnjë zgjidhje tjetër. Për të dytën herë u ngruaja në dhomën e këshillimit. 30 minuta më pas, kryesuesja deklaroi shtyrjen e procesit për në datën 2 korrik, derisa një trupë tjetër të vendosë për kërkesën e avokatit.

Komisioni vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit bazuar vetëm në një kriter, atë të pasurisë



Seanca e djeshme dëgjimore



Gjykatësi Artan Lazaj me avokatin Hazizaj

VENDIMI I BRUNILDA BEKTESHIT

"Kjo trupë gjyquese ka vendosur të përfundojë procesin e rivlerësimit bazuar vetëm në një kriter, atë të pasurisë, duke mos vendosur në këtë mënyrë mbi kriterin e figurës dhe atë profesional", deklaroi Brunilda Bekteshi. Kaq mjaftoi që avokati Sokol Hazizaj t'i kërkonte trupës të tërhiqej dhe ta thërriste të mbrojturin prej tij në seancë, pasi të kishte përfunduar hetimin në të tria kriteret; atë të pasurisë, figurën morale dhe atë të aftësisë profesionale.

kesën e avokatit. Kjo është hera e parë që një subjekt rivlerësimi ngre pretendimin se komisioni duhet ta përfundojë hetimin në të tria shtyllat e procesit, përpara se të thërrasë gjykatësin apo prokurorin në seancë dëgjimore publike. Artan Lazaj e ngriti siparin dhe hapi precedentin, që me

gjasë do të ndiqet edhe nga kolegë të tjerë të tij. Më herët, komisioni ka vendosur për shkarkimin e gjykatësve apo prokurorëve, duke u mjaftuar me përmbylljen e hetimeve vetëm në kriterin e pasurisë. I tillë është rasti i ish-gjykatësit të Kushtetueses, Fatmir Hoxha.

PINGPONGU PROCEDURAL

15 minuta më pas shpallën verdiktin e ndërmjetëm, duke e konsideruar të pabazuar pretendimin e avokatit Hazizaj. Ky i fundit nuk u ndal. I gjendur në krahun e djathtë të Artan Lazajt, i cili miratoi gjithçka në heshtje, avokati kërkoi përjashtimin e trupës gjyquese, të cilën e akuzoi për njëanshmëri në vendimarrje. Trupa duket se nuk pati asnjë zgjidhje tjetër. Për të dytën herë u ngruaja në dhomën e këshillimit. 30 minuta më pas, kryesuesja deklaroi shtyrjen e procesit për në datën 2 korrik, derisa një trupë tjetër të vendosë për kërkesën e avokatit.

Policia vë në pranga dy persona të dyshuar

Thyen qepenin dhe hynë në filialin e postës, grabitësit morën tri kasafortat boshe

DURRËS - Një filial postë është grabitur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në Durrës, ndërsa janë arrestuar dy persona. Burime zyrtare nga policia e qytetit bregdetar bënë me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 04:15 në lagjen nr. 18 të këtij qyteti. Mësohet se dy autorët kanë shkatërruar qepenin dhe më pas kanë dëmtuar derën kryesore. Më pas, ata janë futur brenda dhe kanë nisur të kontrollojë për para. Pasi kishin shpëputur linjën e internetit, autorët kanë harruar kamerat e sigurisë, të cilat punonin. Grabitësit kanë marrë 3 kasaforta, pasi nuk kanë mundur t'i hapin ato se nuk dinin kodet. Por tentativa e tyre rezultoi e dështuar, pasi pak më vonë u kapën nga policia. Kas-



Filiali i postës ku ndodhi grabitja

triot Koçobelli, specialist i Sigurisë dhe Cilësisë në Posta Shqiptare tha për "Gazeta Shqiptare" se brenda kasafortave nuk ka pasur lekë, pasi çdo ditë paratë dërgoheshin në bankë. Ndërkohë, autorët kanë kontrolluar edhe në zyrat e

tjera për lekë, por nuk kanë mundur të gjejnë asgjë, ndërsa kanë bërë rrëmujë. Ndërkaq, policia për arsye hetimore nuk bën me dije emrat e dy personave të dyshuar që u prangosën në lidhje me këtë ngjarjeje. **kl.ha.**



Vodhi dy turistët nga Polonia, përfundon në pranga 44-vjeçari

MEMALIAJ - Policia e Memaliajt ka arrestuar një 44-vjeçar, pasi akuzohet se është autor i grabitjes së një shume parash dhe dokumenteve të dy turistëve nga Polonia. Mësohet se është prangosur Bujar Hyseni, banues në Memaliaj. "Punonjësit e Stacionit të Policisë Memaliaj pas marrjes së njoftimit se dy turistëve të huaj u ishin vjedhur nga motori në parkingun e një lokali në zonën e Krahësit Tepelenë, dokumentet dhe portofoli me një sasi parash, menjëherë nisën punën për identifikimin dhe kapjen e autorit. Pas rreth 1 ore është identifikuar autori, i cili është ndaluar rreth 1.5 km larg vendngjarjes së bashku me lekët dhe dokumentet e vjedhura. Në përfundim të veprimeve u arrestua në flagrancë Bujar Hyseni. Ai ka vjedhur nga çanta, të cilën turistët e kishin lënë mbi motor, jashtë lokalit ku po drekonin, portofolin me lekë, pasaportën dhe disa dokumente të bashkëshortëve polakë T.C., 46 vjeç dhe A.C., 47 vjeç. Materialet në ngarkim të shtetasit të arrestuar i kaluan prokurorisë së Gjirokastrës për veprime të mëtejshme", thuhet në njoftimin e policisë.

Xhaçka: Mirënjohje për sakrificën e çdo ushtaraku

Humbi jetën në krye të detyrës, Dibra nderon me titullin "Qytetar Nderi" kapitenin Floran Delia

DIBËR - Qyteti i Dibrës ka kujtuar dje kapitenin Floran Delia, pilotin e Forcës Ajrore, i cili humbi jetën 2 vjet më parë në një aksidenti ajror. Gjatë ceremonisë së zhvilluar në mjediset e Pallatit të Kulturës në Peshkopi, me vendim të Këshillit Bashkiak, ku e pranishme ishte edhe familja e të ndjerit, kapiteni Floran Delia u nderua me titullin "Qytetar Nderi" (pas vdekjes). Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka gjatë fjalës së saj tha: "Ky angazhim solemn, që në fakt më takon ta marr edhe personalisht në cilësinë e ministres së Mbrojtjes, na detyron të gjithëve të kujtojmë me shumë respekt sakrificën e të gjithë atyre që nuk jetojnë më. Njëherësh është



edhe angazhim për të nderuar të gjithë ushtarakët që i shërbejnë atdheut, që kanë marrë përsipër të rrezikojnë edhe jetën e tyre për të bërë profesionin shumë të nderuar të ushtarakut, por edhe profesionin e rrezikshëm të pilotit". Ndërkaq, ministria Xhaçka falënderoi qytetarët e Dibrës për këtë gjest bujar: "Shumë faleminderit qytetarëve të Dibrës për këtë gjest bujar, por shumë të merituar për heroin tonë! Dhe duke nderuar Floranin, njëherësh kemi nderuar e vlerësuar kontributin e secilit prej 8 mijë efektivëve të FA për të kontribuar për sigurinë e



Ministria Xhaçka në ceremoninë nderimit të kapiten Floran Delia

vendit dhe për jetën e çdo qytetari të Republikës të Shqipërisë", u shpreh Xhaçka. Po me vendim të Këshillit Bashkiak, edhe rruga Ceren-Radomirë do të mbajë emrin e kapitenit të lindur e rritur në Dibër. Kapiten Floran Delia dhe toger Donald

Hoxha ranë në krye të detyrës në mesditën e 6 prillit të vitit 2016 gjatë një fluturimi stërvitor në Grizhë të Malësisë së Madhe. Të dy ushtarakët janë shpallur "Dëshmorët e Atdheut" nga Komisioni Shtetëror për Dëshmorët.

"Volkswagen"-i karambolohet me motoçikletën para komisariatit të Vaut Dejës

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Dy aksidente automobilitike me tre të plagosur rëndë dhe katër të tjerë jashtë rrezikut për jetën kanë ndodhur dje në Shkodër, në afërsi me njëri-tjetrin dhe thuajse në të njëjtën kohë. Në aksidentin e parë që u shënuar rreth orës 16:20 është përfshirë autobusi i Kosovës me targë RKS 05 252 DG, që po lëvizte në drejtim të Lezhës. Mësohet se autobusi është përplasur nga një automjet tip "Ford", që po udhëtonte në drejtim të Shkodrës. Ngjarja ndodhi në rrugën nacionale Shkodër-Tiranë, në afërsi të fshatit Plezhë mes Shkodrës dhe Lezhës. Si pasojë e përplasjes së mjeteve është plagosur rëndë drejtuesja e autovecurës me targë AA 053 MO, Liljana Kullaj 55 vjeçe. Sipas policisë, bashkë me të në makinë ndodhej pasagjerja 58-vjeçare Drita Odeja, e cila ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Liljana Kullaj pasi ka marrë mjekim në spitalin e Shkodrës, është dërguar drejt Tiranës për mjekim të specializuar. Burimet e mësipërme pohuan se për disa minuta 55-vjeçarja qëndroi brenda mjekimit derisa u nxor nga zjarrfikëset dhe policia. Në momentin e aksidentit, autobusi ndodhej plot me pasagjerë, të cilët po shkonin drejt Kosovës. Nga pasagjerët e autobusit të lënduar lehtë janë drejtuesi EL 35 vjeç dhe dy pasagjerë. Në vendngjarje mbërritën uniformat blu, të cilët nisën hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes. Pas rreth 40 minutash, u shënuar një tjetër aksident, jo shumë larg nga vendi ku ndodhi i pari. Një motorçikletë është përplasur me një mjet në fshatin Barbullush të Bashkisë Vau i Dejës. Drejtuesi i motorçikletës që nuk kishte targë, Besim Qerreti dhe pasagjeri Skënder Shehaj kanë marrë frakturat të rënda. Ndërsa, drejtuesi i mjetit tip "Volkswagen" me targë AA 738 SH, Enea Mondri ka marrë dëmtime të lehta dhe është jashtë rrezikut për jetën. Ky i

Përgjaket Shkodra, 3 të plagosur rëndë e 4 të tjerë jashtë rrezikut në 2 aksidente

Makina tip "Ford" u përplas me autobusin e Kosovës në rrugën nacionale Shkodër-Tiranë



Dy aksidentet e djeshme në Shkodër



fundit po priste rrugën, kur nga aksi kryesor i Barbullushit ka ardhur motorçikletë duke shkaktuar këtë aksident. Përplasia ndodhi përpara komisariatit të policisë Vau i Dejës, që ndodhet në Barbullush. Të plagosurit rëndë që ndodheshin në motorçikletë u dërguan me një mjet privat drejt spitalit rajonal të Shkodrës për të marrë ndihmën e parë. Efektivët e policisë ndërhyrën menjëherë duke qenë se aksidenti ndodhi përpara komisariatit në sytë e tyre. Policia po bën hetimet për zbardhjen e plotë të këtij aksidenti. Brenda katër ditëve në Shkodër statistikisht e aksidenteve rrugore janë të frikshme. Janë shënuar 5 aksidente në total me 6 të plagosur rëndë dhe 11 jashtë rrezikut për jetën.

Të rinjtë aksidentohen pas festës së maturës, plagoset rëndë 18-vjeçarja

FIER - Një aksident i rëndë u shënuar në orët e para të mëngjesit të djeshëm në aksin rrugor Fier-Daulas. Mësohet se 18-vjeçari D.M. teksa drejtohte automjetin tip "Volkswagen" është përplasur me mjetin tip "Benz", që drejtohej nga 19-vjeçari K.B. Si pasojë e përplasjes së fortë ka mbetur e plagosur shtetasja me inicialet S.H., 18 vjeçe. Burime nga vendng-



jarja pohuan se në mjetin tip "Volkswagen" ishin duke udhëtuar tre të rinj, të cilët

pas mbarimit të festës së mbrëmjes së maturës, janë nisur për në shtëpitë e tyre. Menjëherë pas aksidentit, vajza është transportuar me urgjencë për në spitalin e Fierit, ku i është nënshtruar një ndërhyrje kirurgjikale. Ndërkaq, policia ka mbërritur në vendngjarje dhe ka nisur hetimet për zbardhjen e shkakut të këtij aksidenti.

U zhduk në rrethana misterioze, gjendet i vdekur vëllai i ish-gjeneralit

MAT - Pas afro 10 ditësh nga zhdukja në rrethana misterioze, vëllai i ish-gjeneralit Gjin Marku nga Bazi i Matit është gjetur i vdekur. Mësohet se Ndue Gjinaj (Marku) 84 vjeç, i cili punonte si bari u gjet dje i pajetë pranë një përroi në Fushë-Mollë. Dyshohet se vdekja ka ardhur për shkak aksidentale. "Nga këqyrja e vendit të ngjarjes si dhe nga veprimet e kryera nga grupi hetimor rezultoi se ky shtetas dyshohet të jetë rrezuar nga një shkëmb dhe si pasojë ka humbur jetën. Materiali proceduralë i kaluan Prokurorisë dhe Komitetit Gjyqësor Mat si "ngjarje aksidentale", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë lokale. I moshuari kishte dalë me bagëti jo shumë larg banesës, por nuk ishte kthyer duke alarmuar familjarët e tij, të cilët kërkuan ndihmën e policisë.

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

Ornela Manjani

Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkuessit janë në qarkun e Korçës. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitetet e kërkuessit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në 'Agjenci' për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

FORMULARI

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkoh informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

APLIKIMI

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

DOKUMENTACIONI QË DUHET TE PARAQISNI

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën në shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjenci'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të thehëruar shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

KORÇË

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuess)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuess)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
217	POGRADEC	VLLI		BULKU	MOS MIRATOJE KERKESEN	
222	POGRADEC	RUSTEM BUFI		BUFI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
223	POGRADEC	MUHAMREEM		CELA	MOS MIRATOJE KERKESEN	
233	POGRADEC	ZINI			MOS MIRATOJE KERKESEN	
210	POGRADEC	PASKO	SPIRO	VAKO	MOS MIRATOJE KERKESEN	
236	POGRADEC	BASHKIM		BESHOLLU	MOS MIRATOJE KERKESEN	
205	POGRADEC	KOSTA	SHEGANI		MOS MIRATOJE KERKESEN	
227	POGRADEC	ENGIJELUSH		CELA	57160	
247	POGRADEC	ILMIE		CEKICI	28781	
249	POGRADEC	TODI		JORGJI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
204	POGRADEC	GEZIM	HAKI	DRAGOI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
219	POGRADEC	KADRI		HYSENBREGASI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
215	POGRADEC	LYTFI		HOXHA		
231	POGRADEC				4644	
213	POGRADEC	PETRO		BARDHI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
205	POGRADEC	ASTRIT		AVDULLARI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
239	POGRADEC	PAVLLO		MATO	MOS MIRATOJE KERKESEN	
250	POGRADEC	SELAMI		PAMBUKU	26618	
208	POGRADEC	SKENDER		CAPOLLARI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
209	POGRADEC	LIRIJE	GAVRIL	SPIROLLARI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
214	POGRADEC	VANGJEL		SPIROLLARI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
215	POGRADEC	RAMAZAN		MUSARAJ	MOS MIRATOJE KERKESEN	
216	POGRADEC	SHABAN		HOXHA	3378	
1181	KORCE	SHPETIM	HYSEN	DVORANI	16900	
1183	KORCE	VASIL		THIMO	41966	
1184	KORCE	NAZMI		DEMIRI	38651	
1185	KORCE	THIMI		ROBO	21750	
1186	POGRADEC	BUKURIE		SAVA	85000	
1187	POGRADEC	NESTI		GJODE	24308	
1188	POGRADEC	LLAZI		SHAMIA	30625	
1192	POGRADEC	ANDON		FODE	55176	
1193	POGRADEC	NEKI		SKENDERASI	19539	
112	BILISHT	IBRAHIM		CANE		
139	BILISHT	KRISTO		KAMBURI	601.4	
114	DEVOLL	FERID		LIMKA	2909	
103	DEVOLL				3000	
150	DEVOLL	MARI		FILO	6138	
131	DEVOLL	ALQI		CIPI	30.92.5	
111	DEVOLL	YLFEJE		RUSI	3080	
122	DEVOLL				2500	
168	DEVOLL	JANI		BAKALLI	22	
161	DEVOLL	ISMAIL		GRACA	8123	
110	DEVOLL	ALI		AGOLLI	6493	
106	DEVOLL	FLAT		MYLAZIMI	700	
132	DEVOLL				600	
113	DEVOLL	SEFFEDIN		PELLUMBI	1488	
116	DEVOLL				100	
121	DEVOLL	SHEMSEHEDIN		ZHUJI	1848	
87	DEVOLL				1388	
102	DEVOLL				13315	
146	DEVOLL				365	
137	DEVOLL	JORDANA		GELEPINI	MOS NJOHIE	
127	DEVOLL	FAHRI		MULLA	2405.5	
95	DEVOLL	AHMET		LIRIONI	227	
145	DEVOLL				22	
94	DEVOLL	VASIL		ARGJIRI	120	
202	DEVOLL	FIRDES		MULLA	MOSNJOHIE	
96	DEVOLL	GAZIM		REVANI	2308.7	
107	DEVOLL	ILIAS		MULLA	1640	
92	DEVOLL	ALKO		MARCO	2395	
152	DEVOLL	MARIKA		PRIFTI	3456	
124	DEVOLL	FEJZE		KOSTURI	6366	

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuess)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuess)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
109	DEVOLL			KARABINA		368
153	DEVOLL	LYTFIJE		LIMKA		60
151	DEVOLL	PELLUMB		NOLLBATI		4540
120	DEVOLL					1640
105	DEVOLL					5633
101	DEVOLL	LLAZARAQ		GJATA		667
142	DEVOLL					4853
123	DEVOLL	ISLAM		MUZIKANTI		781.7
125	DEVOLL	NAUM		TEREZI		399
135	DEVOLL	SANIE		GRACA		9226
154	DEVOLL					3830
148	DEVOLL	QAMIL		XHACI		3830
149	DEVOLL					668
111	DEVOLL					2348
118	DEVOLL					425
128	DEVOLL					11427
97	DEVOLL					999.4
138	DEVOLL					400
110	DEVOLL	ENGIJELUSH		HOXHA		8000
	DEVOLL					600
168	DEVOLL					17714
106	DEVOLL	PETRAQ		PINE		3100
107	DEVOLL	KOSTANDINA		KALICO		2198
109	DEVOLL	XHEMIA		PELLUMBI		107000
111	DEVOLL	NASIF		TALE		15375
112	DEVOLL					5600
113	DEVOLL					14000
114	DEVOLL	VASILUKA		KUQOLI		15000
143	DEVOLL	LEFKOTHE		PETE		6900
98	DEVOLL					4000
116	DEVOLL	MEDEAT		BYLYKU		24207
118	DEVOLL	HILMI		PINCI	36 DY	
119	DEVOLL					4571
120	DEVOLL	PETRI		TOMORRI	10 DY	
121	DEVOLL	MYNYRE		RECI		487.35
173	DEVOLL					768
174	DEVOLL	VASFI		RUSHILAF		MOA MIRATOJE KERKESEN
175	DEVOLL					2500
176	DEVOLL					1850
177	DEVOLL	VANGJUSH		VISHINI		15000
179	DEVOLL					300
	DEVOLL					22 DY
180	DEVOLL	STAVRI		AVEZOLLI		176
181	DEVOLL					MOS MIRATOJE KERKESEN
183	DEVOLL					32950
184	DEVOLL	HYSEN		SHAHOLLI		MOS MIRATOJE KERKESEN
185	DEVOLL	SYBI		SPAHO		3335
186	DEVOLL					
187	DEVOLL	MEHMET		KAMIA		
	DEVOLL					
188	DEVOLL	HEKURAN		ÇUKO		1255
189	DEVOLL	FATME		CANE		25268
	DEVOLL					1500
190	DEVOLL	MITAT		HYSI		32000
132	DEVOLL					1500
	DEVOLL					MOS MIRATOJE KERKESEN
128	DEVOLL					115600
135	DEVOLL					16200
136	DEVOLL					29800
137	DEVOLL					

(vijon)

DEBATI

SHUMË ZHURMË PËR PAK GJË

Risitë e projektligjit që zhduk Teatrin Eksperimental

Aleanca, artistëve: Tërhiqni publikisht firmën tuaj, do mbeten bashkëpunëtorë në krim!

Kauza pesëmuajore që u tradhtua: Jo teatër me Partneritet Publik-Privat

Nuk reflektohet në ligj konkursi ndërkombëtar që kanë kërkuar artistët

Fatmira Nikolli

Qeveria ka miratuar të mërkurën projektligjin që i hap rrugë ndërtimit të Teatrit të ri Kombëtar, e rrjedhimisht, shembjes së atij teatri që kemi sot. Të mërkurën kreu i bashkisë, Erion Veliaj shpalli marrëveshjen me aktorët që protestonin: Arben Derhemi, Alfred Trebicka dhe Altin Basha (regjisor). Megjithatë këta të fundit thanë se ishin bisedime e jo marrëveshje, po atë ditë, Këshilli i Ministrave e kaloi projektligjin. Në sheshin para Teatrit Kombëtar, artistët e tjerë vijuan protestën për dy orë, tanimë, më pak në numër, sepse tre artistët që morën pjesë në takimin me Veliaj, nuk erdhën në protestë.

Tri kërkesat që iu parashtruan Veliajt pjesërisht janë reflektuar në projektligj, por se cili do të jetë fati i truallit të TK-së, mbetet për t'u parë. Protesta që nisi në shkurt ka pasur 'humbje' në pesë muaj, por mbi të gjitha, duket se artistët tradhtuan kauzën kryesore: jo teatër me PPP! Teatri do jetë me PPP dhe ndonëse për "GSH" Alfred Trebicka tha të mërkurën se është kërkuar që të hapet konkurs ndërkombëtar për projekt të teatrit, në projektligjin e miratuar nga Këshilli i Ministrave që pritet të kalojë në parlament, kjo nuk reflektohet. Përkundrazi, aty flitet për kontratë që lidhet me bashkisë dhe kompaninë X që ka propozuar projektin për TK. E projekti është i njohur.

Pyetja është nëse pas pesë muajsh, a u bë ajo çfarë artistët kërkuan. Nëse rezultati është projektligji që kemi në duar, atëherë ka qenë "shumë zhurmë për pak gjë".

Vetë Veliaj u shpreh se, "arrimë një negociatë të suksesshme dhe pastaj mund të kemi shfaqjen e parë në teatrin e ri për 2-3 vite. Diskutimi zgjati disa orë me Derhem-in, që ka qenë kritik dhe i ndjeshëm për këtë çështje, Bashën dhe Trebickën. Ramë dakord që në projektligjin që



do t'i shkojë parlamentit do të përfshihet prezenca e aktorëve si negociatorë, do të sanksionohet që toka e teatrit do të jetë vetëm për teatrin, që do jetë pa kullë, që nuk do t'iu kushtojë asgjë taksapaguesve. Projektligji që kemi sot është fryt i këtyre negociatave".

Por, po të mërkurën, artistët që nuk qenë në takim, vijuan protestën.

"Një pyetje e thjeshtë për të gjithë ata që po mashtrohen nga artificat e kryetarit të bashkisë: - Nëse teatri i ri u ndërtoka me zero lekë nga taksapaguesi, kush do i paguajë lekët, privati? Po pse do i paguajë privati 30 milionë euro pa asnjë fitim, e pa mar-

rë as një copë pronë të Teatrit Kombëtar? Çdo fjalë e këtij publikimi të kryetarit të bashkisë përputhet totalisht me zaptimin e tokës dhe ndërtimin e kullave. I thërrisni mendjes, po ju mashtroni! Po e prishën teatrin, çdo gjë merr fund! Ne jemi për një teatër të ri, në një territor tjetër! Objekti dhe prona e Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Kombëtar Eksperimental të mos preket, por të rikonstruktohet!", shkroi dhe Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit.

E njëjta aleancë shtoi dhe se, "nuk kaluan as 24 orë nga mashtrimi i Veliajt për marrëveshje me artistët dhe dëgjesa të reja dhe ndryshimin e projektligjit sipas

kërkesave të artistëve dhe mashtrimit i doli boja. Qeveria ka miratuar dhe projektligjin dhe e ka mbajtur të fshehtë dhe sot e ka depozituar në Kuvend. Kolegë firmëtarë, mos u fshini pas gishtit. Tërhiqni publikisht firmën tuaj, ose do të mbeten me turp si bashkëpunëtorë në krim! O sot, o kurrë"! Sot, kemi një projektligj që pritet të kalojë në parlament, që i hap rrugë ndërtimit të një teatri me projekt të paracaktuar, ndërtesa të paracaktuar dhe kauza të lëna në mes. Më poshtë po rendisim disa shtesa në projektligjin e miratuar nga qeveria - shtesat erdhën pas bisedimeve.

SHTESAT NË LIGJ

NENI 3

4. "Projekti", ndërtimi i godinës së re të Teatrit Kombëtar dhe zhvillimi i zonës ndërmjet rrugëve "Abdi Toptani" dhe "Murat Toptani", sipas propozimit të paraqitur nga partneri privat.

5. "Prona shtetërore", prona e paluajtshme shtet e pushtetit qendror dhe vendor, që vendoset në dispozicion për zhvillimin e këtij projekti.

NENI 4

Pronat në pronësi shtet dhe statusi i tyre. Sipërfaqja që përbën pronën e Teatrit Kombëtar do të jetë po ajo edhe pas përfundimit të ndërtimit të Teatrit të ri Kombëtar.

NENI 5

Përbërja e komisionit të negociimit

3. Komuniteti i aktorëve teatrorë përfaqësohet në komisionin e negociimit me jo më shumë se dy përfaqësues, të përzgjedhur nga vetë ata.

NENI 6

Kompetencat e komisionit të negociimit

2. Komisioni duhet të verifikojë, paraprakisht, statusin e të gjitha pronave, mbi të cilat do të zhvillohet projekti, përfaqësimi i këtyre pronave si dhe marrëveshjet e arritura nga partneri privat me pronarët privatë, që ka për këto pasuri.

NENI 8

Kontrata dhe përmbajtja e saj

c) Teatri do të jetë i plotë dhe funksional në ditën e dorëzimit sipas afatit të paracaktuar, ku do të përfshihen, ndërtimi i objektit, mobilimi i brendshëm, instalimet teknologjike të skenave, instalimet audio/video, si edhe të çdo elementi tjetër të nevojshëm për një teatër bashkëkohor dhe modern.

ç) Pronësinë e asetëve, përcaktimin e sipërfaqeve përkatëse shtet, që do të vendosen në dispozicion të partnerit privat, duke marrë shteti përsipër garantimin e aksesit në zonë dhe/ose servitutet e kalimit sipas projektit (që garanton hapësirat funksionale të projektit, rrugët e kalimit dhe aksesin publik), lehtësitë dhe kushtet e tjera për t'u plotësuar nga shteti, në shkëmbim të përfundimit të godinës së re të Teatrit Kombëtar dhe sipërfaqeve ndërtimore që mund të përfitojë Bashkia e Tiranës.

g) Standardet artistike, që duhet të ketë teatri

h) Kushtin që mbi tokë, godina e re e Teatrit Kombëtar është një godinë më vete, pa asnjë ndërtim tjetër, përveç pjesëve ndihmëse të saj dhe se i gjithë investimi do të përballohet nga partneri privat, sipas parimit me "çelësa në dorë".

n) Kushtin që partneri privat të fillojë, fillimisht apo paralelisht, godinën e Teatrit Kombëtar gjatë zhvillimit të projektit në zonën urbane.

NENI 9

Nënshkrimi i kontratës

2. Kryetari i Bashkisë Tiranë mund t'i kërkojë komisionit të negociimit të kontratës rishikimin e projektkontratës. Komisioni duhet të rinegociojë dhe t'ia paraqesë për nënshkrim kontratën kryetarit të bashkisë, të shoqëruar me relacionin përmblyllës të negociatave, brenda afatit kohor prej 30 ditësh, duke filluar nga data e kthimit.

Qeveria e vlerëson tokën e Teatrit Kombëtar me 500 milionë lekë

Fatmira Nikolli

Në relacionin që shoqëron projektligjin e qeverisë për projektimin dhe zbatimin e projektit për ndërtimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar me partner privat, jepet edhe një vlerë në lek e truallit të teatrit, në qendër të Tiranës. Relacioni thotë se vlera e 8 465 m2 truallit është rreth 500 milionë lekë, ose më pak se 470 euro për metër katror, në një zonë ku një apartament kushton mbi 2500 euro për metër katror, sipas një llogarie të bere nga BIRN.

Kur flitet për "Vlerësimin për gjendjen e godinës" në relacion shënohet se bazuar në "përfundimin e diskutimeve në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës në vitin 2004, ku IMK i dërgon Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve listën e objekteve monument kulture të kategorisë II, në Qendrën Historike të Tiranës, vërehet se në pikën 70 të listës bashkëlidhur kësaj shkrese, objekti 'Teatri Kombëtar' për-



mendet si 'ndërtësë pa vlera'.

Shtohet se godina e TK-së, referuar vlerësimin të ekspertëve, jo vetëm që nuk plotëson asnjë standard bashkëkohor lidhur me anën funksionale, sigurinë e strukturës, sistemet e ruajtjes nga zjarri, ato elektrike, të ngrohjes etj., por edhe nëse kryet rikonstruksioni i saj, sado i kushtueshëm dhe i thellë të jetë,

nuk e sjell atë në kushtet optimale teknike të sotme, sipas kodeve të projektitim.

VLERËSIMI FINANCIAR

Në relacionin shoqëruar të ligjit, vihet në dukje se Ministria e Kulturës është shprehur që nuk disponon mjetet e mjaftueshme financiare për realizimin e këtij investimi, për më tepër nuk e ka parash-

ikuar këtë investim as në PBA (2018-2020).

Po aty vërehet se grupi i punës ka gjykuar se Ministria e Kulturës e ka të pamundur të parashikojë fond investimi për objektin e Teatrit Kombëtar, duke pasur parasysh edhe tavanet buxhetore.

"Pronari-shtet, në zonën ku propozohet që të zhvillohet projekti, ka një sipërfaqe prej

8 465 m2, nga të cilat, rreth 2 100 m2 janë pronë e Bashkisë së Tiranës. Vlera e objektit të Teatrit Kombëtar, sipas të dhënave të bilanci të institucionit, përlogaritur këtu amortizimi i godinës në vite, është 95.567.619 lekë", thotë relacioni. Në vijim, shënohet se vlera e pronave shtetërore truall, e përcaktuar në zonën e projektit, sipas cimitit të referencës së miratuar me vendimin nr.89/2016, të Këshillit të Ministrave, është rreth 500 milionë lekë.

Ndaj, thotë relacioni, "në pamundësi për të realizuar zhvillimin publik me fonde buxhetore, ky propozim siguron që të merret më e mira e bashkëpunimit ndërmjet pronarëve (shtetëror dhe privatë), publikut, investitorit:

- duke maksimizuar vlerën e asetit publik apo privat që kanë në dispozicion;
- duke optimizuar vlerën e zhvillimit në qendër të Tiranës dhe të nevojës publike për teatër e shërbime të tjera;
- duke maksimizuar vlerën e financimit të sipërmarrjes;
- duke transferuar të gjitha risqet të zhvilluesit".

Relacioni thotë se sipas këtij bashkëpunimi me part-

nerin privat, avantazhi kryesor është që shteti realizon ndërtimit e Teatrit të ri Kombëtar në një kohë shumë të shpejtë (3 vjet), vetëm nëpërmjet dhënies të së drejtave për zhvillim dhe pa asnjë financim publik apo fond buxhetor, duke realizuar në këtë mënyrë, përmeshjen e një ëndrrë të artistëve për të luajtur në kushte dinjitoze për ta, por edhe për publikun artdashës. Po kështu, krahas teatrit, zhvillohet edhe e gjithë zona në afërsi të qendrës, duke i sjellë vlerë të shtuar kryeqytetit dhe duke përmëshur të drejtat/kërkesat legjitime të pronarëve privatë për zhvillim.

Në fund shënohet se projektligji parashikon financim tërësisht me fonde private të godinës së re të Teatrit Kombëtar dhe që godina t'i dhurohet shtetit shqiptar. Vlera e pronës shtetërore, përfshirë edhe godinat të angazhuara nga ana e shteti shqiptar, është rreth 6 milionë euro, ndërsa vlera e godinës së Teatrit Kombëtar, që do të përfitohet është rreth 30 milionë euro.

PROTESTA E ATYRE QË MBETËN (NJË BIE E MIJËRA NGRIHEN)

Fatmira Nikolli

Kjo punë do të kërkojë vballen e Kukësit e gunë përmbi tela. Erion Kristo ishte ndër të fundit që foli dje në sheshin para dy teatrove në protestën e atyre që mbetën. Atyre që mbetën për të mbrojtur truallin e teatrit. Shumë kanë ikur, bashkë me fjalimet plot patos. Një grusht artistë kanë mbetur, por, një bie e mijëra ngrihen. Kur u mor vesh se protesta vazhdon, se nuk pati marrëveshje me kreun e bashkisë sikundër u deklarua, pothuaj të kënaqur që nuk u tradhtuan, qytetarët mësynë në shesh. Dhe zor se do ndalen, megjithëse Alert Çeloalliaj tha se sot, është i pajfallë.

"Sot jam pa tekst. Për 27 vite me radhë qeverive tonë nuk u ka interesuar teatri. Papritur pa kujtuar për 24 orë çështja këthehet në emergjencë dhe kalon në parlament me procedurë të përshpejtuar. Faleminderit atyre që kanë ardhur të ndajnë

dhimbjen me ne. Sot, SASE ka rikonfirmuar vendimin 5 major që do vijojmë gjendrimin e ruajtjes restaurimit a rikonstruksionit. Jemi pro ndërtimit të një teatri të ri diku tjetër dhe ruajtjes së dy godinave të TK dhe TKE. Në peticione kanë vënë emra që s'kanë firmosur. Ne do të vazhdojmë të jemi këtu", -tha ai.

PLANI

Robert Budina tha dje në protestë se kalimi i ligjit në qeveri është atentat kundër demokracisë. "Nuk bëhet fjalë më vetëm për TK, por për demokracinë. Ju bëj thirrje shqiptarëve të mbrojnë lirinë e tyre. Ju lutem, ndaloni masakrën që po i bëni vendit".

Pas tij, Gentian Zenelaj mori fjalën duke dashur të shante e përdhoste. "Sot kam kuptuar që talenti është dhunti, por të jesh i lirë është një zgjedhje. Të jesh trim është zgjedhje. Të kundërshtosh diktaturën është zgjedhje. Sot është ditë

shumë e trishtë. Unë punoj me ballin lart e paguaj taksa me ballin lart. Kam parë si janë zbythur vlerat normale. Sot kam parë se si tradhtia ndodh natën e ditën shitet si kompromis ditën. Po ju them atyre uroj që të vijë dita ta bëni gjumin e qetë. Më kanë akuzuar mua që jam partiak. Ju keni vetëm një parti: atë të lekut. Zoti juaj është leku, ju bëni be te leku. Kam keqardhje të madhe kam. Kiço mos qaj do bëjmë teatrin më të mirë. Ne bëjmë teatër në rrugë. Do bëjmë teatër më të mirë", -tha Zenelaj.

Taulanta Jupi nga SASE tha se pati kërkuar sherr në mëgjesjen me Veliajn që të mos ndodhnin ato që ndodhën sot.

Prej artistëve të mbetur Neritan Liçaj tha se kjo, nuk është përshpirtje për Teatrin Kombëtar. "Ata që i vodhën këtij vendi tokën e ajrin, duan t'i marrin nderin.

Ejani, ju deputetë, policë

me kaska e pa kaska. Ejani me ballin lart e paguaj taksa me ballin lart. Flakën do i shihni Teatrit Kombëtar. Këtu kemi pasur dhimbjen e të ftohtin. Nuk e lëmë. Ejani këtu".

Ai kujtoi se policët shqiptarë janë policë të një shteti të NATO-s ndaj kanë të drejtën të mos e zbatojnë urdhrin e shefit kur shefi qmendet. "Ju policë ç'a do u thonë fëmijëve në darkë? Që shkuam kundër artistëve? Kundër flamurit tonë?".

KËRCËNIME(DY LLOJE)

Ervin Goce tha dje se ministrja që po zgërdhihej dje dhe madje i përshëndeti, por kujtoi se "nëse situata precipiton qytetarët do e marrin me shkelma rrugëve të Tiranës. Teatrin nuk e lëshojmë. Sot i doli që teatrit i vlen 450 euro metri truallit. Kjo nuk ka sens". Dhe ky, ishte kërcënim i parë.

Të dytin në formë këshille e dha deputeti i PD

Qëndresa vazhdon, protesta deri në pushtim të Teatrit



Agron Shehaj. "Nëse doni ta shpëtoni këtë teatër, futuni brenda. Nëse doni ta mbrojni, futuni brenda. Unë do jem me ju, jam i pari që futem e i fundit që dal", -tha ai. Në fund qytetarë të Kukësit të ardhur në protestë kërkuan që të mos ketë frikë. "E patë Kukësin

ç'a ndodhi? Shqiptarët janë ndeshur me serbë e nuk janë ndalur. Të mbyllemi brenda se është i shenjtë. Shqipëria s'ka qenë më e rrezikuar se sot. E siç thoshte Gjergj Fishta: N'daçi me ditë sa shkon jeta, sa keni forca, keni të drejta".

Provokojnë serbët me parulla nacionaliste, veshin bluza me foto të Millosheviçit

Prag konflikti? Vulinit i ndalohet hyrja në Kosovë

MPJ: Arrestohet ministri serb nëse shkel kufirin

Ditën e djeshme qytetarë serbë i janë bashkuar një manifestimi në Vidovdanit në Gazimestan, disa kilometra larg Prishtinës, ndërsa kanë provokuar me mbishkrime nacionaliste. Mediat kosovare kanë publikuar disa foto ku serbët shihen të veshur me bluza që kanë të stampuara foto të Sllabodan Millosheviç dhe Ratko Mladiç. Po ashtu, kishte edhe nga ata qytetarë që mbanin veshur edhe bluza me mbishkrime "Kosova është Serbi" dhe flamuj të Serbisë. Këtë herë nuk ishin të pranishëm përfaqësuesit më të lartë të institucioneve të Beogradit. Policia ka ndër-marrë të gjitha masat e sigurisë për tubimin publik, si dhe ka garantuar siguri për pjesëmarrësit. Kjo protestë në Beograd është parashikuar që të bëhet kundër dialogut të Brukselit. Siç njofton "B92", protestën e organizojnë shoqatat "Nuk ka dorëzim të Kosovës", "Nuk i japim fëmijët", "Serbë mblidhuni", "Cirilike" dhe Sindikata e Pavarur e Policëve. Mësohet se pjesëmarrje në protestë e ka paralajmëruar edhe kryetari i Këshillit Iniciativ për Serbinë e Shëndoshë (Zdrava Srbija) Milan Stamatović. Ai deklaroi më herët se presidenti Aleksandar Vučić "po përpiqet që popullit serb t'ia rrimbejë sovranitetin dhe t'ua falë atë terroristëve Haradinaj dhe Thaçi, me qëllim të vazhdimtë të integritimit të pasigurt europain". Ndërkohë që Njësia Speciale e Kosovës është nisur drejt Veriut të Kosovës, me qëllim që të parandalonë hyrjen ilegale, siç thonë mediat e Kosovës, të ministrit serb të Mbrojtjes, Aleksandar Vulin, të cilit iu mohua leja për të hyrë ligjërisht në Kosovë. Lajmin për ndalimin e hyrjes së ministrit serb e ka konfirmuar dje edhe ministri i



MEDIAT SERBE

"Zyra për Kosovën dënon vendimin e Prishtinës dhe ndërmjetësuesit e dialogut në Bruksel. Ai vendim i mor për ta poshtëruar Serbinë", thuhet në reagimin e tyre nga gazeta serbe "Pink".

Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli. I pyetur në lidhje me zyrtarët serbë që kanë kërkuar leje të hyjnë në territorin e Kosovës për manifestimet e sotme, Pacolli tha se vetëm ministrit të Mbrojtjes së Serbisë, Aleksandar Vulin, i është ndaluar hyrja. Ministri Pacolli nuk ka dhënë përgjigje në lidhje

me arsyen e refuzimit të kërkesës së Vulinit, i cili pritet të marrë pjesë në manifestimet për festën ortodokse të Vidovdanit. Mirëpo, nëse Vulin tenton që të hyjë në territorin e Kosovës ilegalisht, atëherë policia e Kosovës do ta zbatojë ligjin. Këtë gjë e ka bërë të ditur Jetlir Zyberaj, këshilltar i ministrit

JETLIR ZYBERAJ

"Çdo provokim që mund të bëhet, pasojat do t'i bartë Beogradi ngase provokime të tilla i bën qëllimshëm. Partnerët ndërkombëtarë janë të njoftuar për çdo veprim tonin. Përtej konspiracioneve që rëndom prodhohen pastaj, është shumë e qartë se futja ilegale e kujtdo në territorin e Kosovës, nënkupton zbatim të ligjit nga policia e Kosovës", ka shkruar këshilltari i ministrit të Punëve të Jashtme, Zyberaj.

njoftuar për çdo veprim tonin. Përtej konspiracioneve që rëndom prodhohen pastaj, është shumë e qartë se futja ilegale e kujtdo në territorin e Kosovës, nënkupton zbatim të ligjit nga policia e Kosovës", ka shkruar Zyberaj në "Facebook".

REAGIMI I SERBIË: NGJARJA ME VULIN, SKANDAL

Zyra e ashtuqajtur për Kosovë në Serbi e ka cilësuar si skandal vendimin për ndalimin e hyrjes së ministrit serb të Mbrojtjes, Aleksandar Vulin në territorin e Kosovës, për festën e Vidovdanit. Sipas tyre, pas kësaj qëndron Kosova dhe ndërmjetësuesit evropian në dialog, shkruan gazeta serbe "Pink". "Zyra për Kosovë dënon vendimin e Prishtinës dhe ndërmjetësuesit e dialogut në Bruksel. Ai vendim i mor për ta poshtëruar Serbinë", thuhet në reagimin e tyre, transmeton "lajmi.net". Më tej, gazeta shkruan se Vulin do të mbajë konsultime urgjente me presidentin serb, Aleksandar Vučić për këtë çështje. Ndërkohë, Aleksandar Vulin nuk do të mund të hyjë në Kosovë nesër për të marrë pjesë në festimet e Vidovdanit, pasi autoritetet kosovare ia kanë ndaluar atij hyrjen në shtetin e Kosovës.

të Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli. Sipas Zyberajt, edhe partnerët ndërkombëtarë të Kosovës janë të informuar për të gjitha veprimet që do të ndërmarrë Kosova. PARALAJMËRIMI MPJ: NESE VULIN HYN NE KOSOVE, ARRESTOHET "Çdo provokim që mund të bëhet, pasojat do t'i bartë Beogradi ngase provokime të tilla i bën qëllimshëm. Partnerët ndërkombëtarë janë të

SHKURT

Rriten vrasjet në Londër, shkon në 81 numri i viktimave

Një 20-vjeçar u gjet i vrrarë me thikë në Londër, duke shënuar vrasjen e 81 për këtë vit. Policia po heton ngjarjen pas një përlleshjeje midis dy grupeve të armatosur me shkopinj bejsbolli në veri të Londrës. Sipas "Daily Mail", i riu kishte plagë të rënda dhe u shpall i vdekur në vend, pavarësisht nga përpjekjet e mjekëve të ndihmës së shpejtë.

Kenia, 15 të vdekur nga zjarri, mes tyre 4 fëmijë

Të paktën 15 persona janë vrrarë nga një zjarr në një treg në kryeqytetin kenian Nairobi. Më shumë se 70 persona mbetën të plagosur nga zjarri, i cili shpërtheu në mes të natës duke shkatërruar shumë prona. Gikomba është një nga tregjet më të mëdha në qytet dhe zjarret janë të shpeshta. Megjithatë, shkaku i zjarrit ende nuk bëhet i ditur. Sipas "BBC", katër fëmijë janë mes viktimave. Disa nga viktimat u dogjën, ndërsa të tjerë u asfiksuan teksa po përpiqeshin të shpëtonin pronat e tyre.

Gjermani, 3 të vdekur nga shpërthimi në një shtëpi

Tre persona kanë humbur jetën mëngjesin e së enjtes pas një shpërthimi të fuqishëm në një shtëpi në qytetin e Bremenit. Agjencitë gjermane të lajmeve raportojnë se shpërthimi, shkakët e të cilit nuk janë përcaktuar ende, ndodhi në papafingon e një vile në qytetin e Gjermanisë Veriore. Forcat e shpëtimimit mbërritën menjëherë në vendin e ngjarjes, ku gjetën trupin e një gruaje 41-vjeçare dhe të të birit 7-vjeçar. Si pasojë e shpërthimit po ashtu humbi jetën edhe një 70-vjeçare që jetonte në banesën pranë. Hetuesit po punojnë për zbardhjen e plotë të shkaqeve të shpërthimit, që shkatërroi tërësisht shtëpinë.

Malta pranon anijen "Lifeline" me 230 emigrantë

Anija "Lifeline" me 230 emigrantë në bord u ankorua në portin Maltës, 5 ditë pas bllokimit në ujërat e Mesdheut. Autoritetet malteze pranuan të hapin portin për anijen, pas presioneve të shumta nga vendet e BE, kryesisht nga Italia. Kryeministri maltez, Zhozef Muskat tha se vendi i tij nuk ka detyrim ligjor të presë anijen, por po e bën si një veprim humanitar. Emigrantët e shpëtuar në det nga ekipazhi i anijes holandeze do të shpërndahen në Maltë dhe në 5 vende të BE, Itali, Francë, Irlandë, Portugali dhe Poloni.

SULM ME ARMË NË REDAKSINË E NJË GAZETE NË SHBA, 4 TË VRARË DHE 20 TË PLAGOSUR

Të paktën 4 të vrrarë dhe 20 të plagosur është bilanci i sulmit me armë në redaksinë e një gazete në Maryland të SHBA-ve. Sipas medieve amerikane janë sulmuar zyrtarë qendrorë të gazetës lokale "Capital Gazette". Gazetari Phil Davis konfirmoi se shumë njerëz nuk është ende e qartë se çfarë ka ndodhur, por mësohet se agresori është arrestuar.



FOTOLAJMI



Vučić: Jemi gjithmonë të interesuar për bisedime

Ndihmëssekretari Mitchell flet me Vučićin, optimist për një zgjidhje Kosovë-Serbi

Kryetari i Serbisë, Aleksandar Vučić ka biseduar të mërkurën në telefon me ndihmëssekretarin amerikan të Shtetit për Europën dhe Euroazinë, Wess Mitchell rreth situatës në rajon e në veçanti për vazhdimin e dialogut ndërmjet Beogradit e Prishtinës. Dy bashkëbiseduesit janë pajtuar që Beogradi dhe Uashingtoni rregullisht dhe shpesh të këmbëjnë informata për rrjedhën e dialogut. Theksohet se Mitchell e ka përshëndetur vazhdimin e bisedave ndërmjet Thaçit e Vučićit dhe ka shfaqur shpresën për arritje kompromisi rreth zgjidhjes. Mitchell ka thënë se Serbia për SHBA-të është shtet dhe partner i rëndësishëm. Vučić ka theksuar se Serbia është gjithmonë e interesuar që të bisedojë. Ai e ka falënderuar Mitchellin për interesimin rreth dialogut me Kosovën.

Migrimi e zvogëlon Bashkimin European nga lindja në perëndim

Kriza e emigracionit në Europë: A është fundi i BE-së?

Jean-Claude Juncker: Brishtësia e BE po rritet

Marrë nga BBC

Euroskeptikët mund të duan të mendojnë se BE është në telashe, po ndërsa liderët mbledhen në Bruksel për samitin e tyre të verës të enjten, eurofilët e përkushtuar gjithashtu po ngrenë alarme. "Brishtësia e BE po rritet", paralajmëron shefi i Komisionit të BE Jean-Claude Juncker. "Plasaritjet po rriten në numër". Ka qenë e lehtë të shpërgjendohesh gjatë dy javëve të fundit nga qeveria e re italiane dhe refuzimi i anijeve të shpëtimit të emigrantëve të OJQ-ve. Por zoti Juncker ka të drejtë, ndarjet e BE-së shkojnë më thellë dhe janë më të përhapura. Emigrimi vë Europën Jugore kundër asaj të Veriut. Italia dhe Greqia ziejnë përbrenda nga pakënaqësia, pasi janë lënë vetëm për t'u marrë me ardhjen e emigrantëve. Ndërkohë, vendet e veriut fajësojnë jugun se nuk ka patrulluar më mirë kufijtë e tyre mesdhetarë. Migrimi e zvogëlon BE-në nga lindja në perëndim gjithashtu. Shtetet anëtare më të reja nga Evropa Qendrore dhe Lindore nuk kanë nënshkruar asnjëherë vizionin e pas Luftës së Dytë Botërore "një për të gjithë e të gjithë për një". Kur bëhet fjalë për solidaritetin e BE-së dhe ndarjen e detyrimeve, ata janë jobesimtarë të zjarrta. Ato me vendosmëri u kthejnë shpinën kur Italia dhe Gjermania pretendojnë për kuota të emigrantëve. Numri i emigrantëve që vijnë në mënyrë të paligjshme në Evropë mund të jetë i ulët, por po kështu është toleranca e votuesve të problemit. Rritja e numrit të politikaneve që mbajnë qëndrim të ashpër ndaj emigracionit në të gjithë BE-në, ka inkurajuar përkrahësit e linjës së ashpër si Victor Orban i Hungarisë dhe Sebastian Kurz i Austrisë, i cili merr presidencën e BE-së këtë gjashtëmuor të shtytë emigracionin si një përparësi kryesore. "Mbajni ato jashtë", është qëllimi kryesor i Austrisë ndërsa kreu më me influencë i Europës, Angela Merkel, arin në Bruksel të enjten duke shtyrë dhe duke u lutur për kompromis mbi ndarjen e detyrimeve dhe parandalimin, numri i udhëheqësve të BE-së vendosin të parandalojnë emigrimin po rritet. Kjo më sjell në shtresën e ardhshme të ndarjeve evropiane të provokuara nga migrimi: brenda qeverive kombëtare, si dhe midis vendeve. Gjermania është shembulli më dramatik. Zonja Merkel është dobësuar në mënyrë të qartë në shtëpi nga politika e saj e mëparshme me dyer të hapura për emigrantët. E konsideruar si politikisht e paprekshme kancelares gjermane tashmë i është dhënë një ultimatum nga ministri i saj i brendshëm.



"Deri në fund të këtij samiti në Bruksel, ju duhet të vini në shpatë një zgjidhje të zbatueshme pan-evropiane për të ndaluar emigrantët e paligjshme që derdhen gjatë në Gjermani", ka kërcënuar Horst Seehofer. "Ose do të mbyllim në mënyrë të njëanshme kufijtë e Gjermanisë". Qeveria austriake tha këtë javë se do të duke shkaktuar një efekt domino të kufirit në të gjithë Evropën, me një impakt

sizmik në projektin politik dhe ekonomik të çmimit të BE-së: marrëveshja e Shengenit për kufirin e jashtëm. Kjo do të ishte një goditje për Brukselin dhe makth për Gjermaninë, e cila është lidere e eksportit në Europë. Sigurisht që nuk jemi atje akoma. Në stilin e vërtetë të Bashimit European, sapa u mblodh rreth një tavoline këtu në Bruksel, padyshim do të theksohet se çfarë i bashkon më tepër vendet anëtare. Për

sa i përket migrimit, udhëheqësit e BE-së lehtë do të bien dakord të forcojnë rojet e tyre kufitare Frontex. Ka gjithashtu rritje të konvergencës rreth idesë së krijimit të të ashtuquajturave qendra të zbarakimit jashtë BE-së për të identifikuar emigrantët ekonomikë, të cilët në teori mund të dërgohen në shtëpi. Atyre që kanë të drejtën e azilit apo statusit të refugjatis mund t'u jepen pasazhe të sig-

urta dhe ligjore për në Evropë. Dhe flitet shumë për një bashkëpunim më të ngushtë me vendet e emigrimit të origjinës dhe vendet e transitit që emigrantët kalojnë për të bërë rrugën e tyre për tek anijet e kontrabandës. Por këto ide janë më të lehta për tu formuluar sesa për të kryer. Ju do të keni nevojë për shumë roje kufitare të BE për të patrulluar milje të vijës bregdetare në Evropën Jugore. Ju do të keni nevojë për leje nga shtetet afrikane si Nigeri dhe Çad për të ngritur qendrat e përpunimit, për shembull. Deri tani ky është një objektivi i largët. Burime të qeverisë gjermane më thanë se i dhanë këtij projekti tri mundësi për mbijetesë, falë natyrës gjithnjë e më nacionaliste të shumë qeverive evropiane. "Dhe nëse Schengen dështon - parashikojnë ata - ky do të ishte fillimi i fundit i Bashimit Evropian". Është shumë herët për të paralajmëruar rënien e BE-së apo madje edhe fundin e karrierës së zni. Merkel në qeveri si rezultat i kësaj krize politike në Evropë. Por, siç presidenti i BE-së, Donald Tusk u tha krerëve të BE-së në prag të mbërritjes së tyre: "Pengesat janë shumë të mëdha dhe koha është e shkurtër".

SHKURT

Juncker: BE nuk merr vendime për vendet e Afrikës

Liderët e BE-së nuk duhet të jenë shumë të sigurt në vendimin e tyre për ngritjen e të ashtuquajturave "platforma zbarakimi" për pritjen e migrantëve në vendet e Afrikës së Veriut, pa i pyetur fillimisht ato, paralajmëroi sot presidenti i Komisionit European, Jean-Claude Juncker. "Dua të vë në dukje se ne këtu në Bruksel nuk mund të marrim vendime për vendet e Afrikës së Veriut", tha ai. Ai u kërkoi disa liderëve evropianë të tregonin vetëpërmbytje kur marrin vendime për qendrat e migrantëve jashtë territorit të BE-së. "Nëse japim mesazhin se afrikanët duhet të bëjnë atë që themi ne, kjo do të jetë e gabuar - theksoi ai. - Ne nuk duhet t'u krijojmë atyre idenë se ky është një neokolonializëm", tha Juncker.

Putin: Kemi tërhequr mijëra trupa e mjete

ushtarake nga Siria

Presidenti rus, Vladimir Putin ka njoftuar se rreth 1.000 anëtarë të personalit ushtarak dhe dhjetëra pjesëtarë tjerë të forcave ajrore janë tërhequr nga Siria në ditët e fundit. Duke folur në një ceremoni për të diplomuarit ushtarakë në Kremlin më 28 qershor, Putin ka thënë se tërheqja është duke vazhduar. "Trembëdhjetë aeroplanë, katërmëdhjetë helikopterë dhe 1,140 persona anëtarë të stafit janë larguar nga Siria në ditët e fundit", ka thënë Putin. Rusia ka nisur një fushatë me bomba në Siri në shtator të vitit 2015, e cila është kthyer në favor të presidentit sirian, Bashar al-Assad në luftën civile shtatëvjeçare. Putin kishte deklaruar për tërheqjen e trupave ruse nga Siria në mars të vitit 2016, mirëpo nga ajo kohë ka pasur pak shenja të zbatimit të vendimit - shkruan "REL". Në muajin dhjetor, Putin sërish kishte urdhëruar tërheqje të pjesësme të forcave ruse, mirëpo nga ajo kohë luftimet janë zhvilluar në pjesë të ndryshme të territorit sirian.

John Bolton, në Moskë për takimin e ardhshëm Trump-Putin

Bisedime për pikëtakimin e dy presidentëve, hollësitrat bëhen të ditura të enjten

Zyrtarët e Kremlinit thonë se ekziston një marrëveshje që presidenti rus, Vladimir Putin dhe presidenti Donald Trump të takohen në një vend të tretë. Njoftimi u bë të mërkurën, ndërkohë që këshilltari amerikan i Sigurisë Kombëtare, John Bolton ndodhet në Moskë për bisedime me zotin Putin dhe zyrtarë të tjerë të lartë rusë. Ndihej si Kremlinit për politikën e jashtme, Yuri Ushakov, tha se hollësitrat lidhur me vendin ku do të mbahet takimi Trump-Putin do të bëhen të njohura të enjten. Takimi pritet të

mbahet, pasi presidenti Trump të marrë pjesë në takimin e NATO-s më 11 dhe 12 korrik dhe pasi të ketë vizituar Britaninë më 13 korrik. Ndërsa vendet ku thuhet se mund të mbahet takimi janë Vjena dhe Helsinki. Më parë, presidenti rus Putin i tha zotit Bolton se vizita e tij në Moskë ka shtuar shanset për përmirësimin e marrëdhënieve mes Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë. Zoti Putin tha marrëdhëniet mes dy vendeve nuk janë në "gjendjen më të mirë të mundshme". Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, u tha

gazetarëve se situata jo e mirë e marrëdhënieve mes dy vendeve është temë që do të diskutohet në takim, krahas një sërë çështjesh të tjera ndërkombëtare. Zoti Bolton tha se shpreson që vizita e tij njëllojëshe të përgatisë terrenin për atë që do të jetë takimi i parë i zyrtar mes presidentëve Trump dhe Putin. Dy udhëheqësit janë takuar më parë në kuadrin e konferencave ndërkombëtare dhe kanë biseduar disa herë në telefon. Marrëdhëniet mes Uashingtonit dhe Moskës janë tensionuar, për shkak të rolit të Rusisë në konfliktin e



Sirisë dhe të dyshimeve për helmimin nga Rusia të një ish-agjenti rus në Britani. Marrëdhëniet u keqësuan sidomos pas aneksimit nga Rusia të Krimisë dhe ndërhyrjes ruse në zgjedhjet presidenciale amerikane.

Opinion i Ditës

Hapja e dyerve të BE, vendim historik për Shqipërinë

Nga Rexhep QOSJA

(vijon nga faqja 1)

... në përgjithësi. Këtë ditë shqiptarët morën premtimin se dyert e Bashkimit Evropian do të hapen për Shqipërinë: në vitin 2019 do të fillojnë bisedimet për integrimin e Shqipërisë në këtë Bashkim që u ka sjellë premtime historike popujve evropianë.

Rruga e Shqipërisë deri te kjo e arritur historike nuk ishte e lehtë. Dhe nuk ishte e lehtë pse duhej bërë ndryshime, duhej bërë reforma në një varg fushash të jetës politike, shoqërore, shtetërore e të tjera, që s'ishin menduar më parë, por edhe pse duhej mënjanuar pengesat që qeverisë shqiptare i bëheshin prej disa forcash politike bashkatdhetare.

Vonesat e njohura poli-



tike duhej tejkaluar me nxitime që të shpesh të herëve nuk pranohen lehtë prej shqiptarëve të tyre.

Kërkesat evropiane duhej përbushur jo vetëm me programe, por në të njëjtën kohë edhe me vlera,

me sjellje, me mendimet, me standarde evropiane në jetën e përditshme shoqërore, politike, arsimore, kulturore e të tjera të shqiptarëve.

Dhe, kështu qeveria shqiptare në krye me Edi

Ramën bënte përpjekjet më të frytshme të njëkohshme: për ta çuar Shqipërinë në Evropë dhe për të sjellë Evropën në Shqipëri.

Mund të konsiderohet e arritur e qeverisë shqiptare dhe e Shqipërisë

edhe kjo e dhënë: më shumë se asnjëherë në historinë shqiptare sot është shtuar numri i miqve evropianë ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve. Dhe, kjo u pa edhe më 26 qershor.

E uroj Shqipërinë për

Mund të konsiderohet e arritur e qeverisë shqiptare dhe e Shqipërisë edhe kjo e dhënë: më shumë se asnjëherë në historinë shqiptare sot është shtuar numri i miqve evropianë ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve. Dhe, kjo u pa edhe më 26 qershor.

këtë fitore të madhe politike e diplomatike, që përmban idealin e popullit shqiptar për të qenë edhe me kuptimet e me vlerat jetësore aty ku e ka caktuar gjeografia: në Evropë e me Evropën.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Opinion *i* Ditës

Rama nuk arriti të hapë negociatat, por ia doli të shmangë turpërimin

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... disa gjëra të thjeshta që duhen saktësuar.

Po, Edi Rama dhe taborët e tij kanë një lloj të drejte të ndihën të lehtësuar. Ata arritën të shpëtojnë fytyrën dhe të shmangin turpërimin, sepse rezultati para mbledhjes të Këshillit të marrëdhënive të Përgjithshme të Luksemburgut mund të ishte edhe më i keq. Deri pak ditë më parë, në tryezë ndodhej varianti që Shqipërisë t'i thuhej një "Jo" e plotë. Pas votimit negativ të parlamentit holandez, këmbënguljes mohuese të Francës dhe intransigjencës së Danimarkës, Shqipëria jo vetëm rrezikohet të mbetet në klasë, por ajo kanosej edhe nga skenari më i errët i mundshëm, ndarja e fatit të saj nga Maqedonia. Në tryezat e Brukselit, deri në mbarim të javës që shkoi, qarkullonte edhe një version, që fqinjët tonë sllav t'i hapet drita jeshile, ndërsa në të refuzoheshim për të tretën herë radhazi.

Falë një grupi vendesh që mbështesin politikën e zgjerimit, falë skrupujve të anëtarëve më të fuqishëm të BE-së, për të mos krijuar një hendek mes Komisionit Europian që kish dhënë një rekomandim pozitiv dhe shefave të shteteve që nuk gjenin dot konsensus, u arrit që të shpikje një formulim më i butë: të thuhej një "PO" që më shumë anon nga "JO-ja".

Në këtë kuptim Edi Rama që e pati shndërruar në një bast personal, hapjen e negociatave këtë 28 qershor, mund të ndihet si pacienti që e kanë lejuar të marrë edhe një serum më tepër. Ai arriti ta evitonte përbaltjen ekstreme dhe të shmangë një refuzim shqeto, të pastër dhe pa ekuivoke.

Por, gjithsesi ajo që arriti ishte shumë larg asaj që shpresonte dhe asaj që kishte premtuar. Qeveria e tij ka mbi tryezë një tufë me kushte që ka qenë e paaftë t'i përmbushë për vite me radhë (lexo më poshtë), dhe që vështirë se dikush shpreson se do t'i përmbushë për 12 muaj. Që negociatat të quhen realisht të hapura do të duhet që ato të plotësohen deri në mbledhjen e qershorit 2019 dhe vetëm pasi Këshilli i BE-së ta konstatojë këtë.

Por, problemet tona nuk mbarojnë këtu.

Në propozimin e sotëm thuhet shprehimisht se "në varësi të progresit të arritur" konferenca e parë mes qeverisë shqiptare dhe BE do të zhvillohet në fund të 2019.

Pra, që tani kemi të bëjmë me një shtyrje kohore prej 18 muajsh, ndërkohë që vendet në garë me ne i kanë zhvilluar konferencat ndërqeveritare, vetëm gjysmë viti nga ajo që është konsideruar



si hapje zyrtare negociatash. Dhe kalvari nuk përfundon me kaq.

Askush nuk e di se ç'do të ndodhë nëse Shqipëria sërish nuk i plotëson detyrimet e saj. Askush nuk e di sesa mund të shumëfishohet ky 18 muajsh i servirur tani si fitore. Askush nuk e di se kur negociatat do të

hapen realisht dhe se kur do të kemi një datë për t'u ulur konkretisht në tryezë.

Të gjitha këto paqartësi, pikëpyetje dhe dyshime i japin më tepër të drejtë atyre që i mëshojnë idesë të dështimit. Sepse Rama e humbi bastin personal të ngjijtjes së një shkalle drejt BE. Ajo që ka arritur, shumë e rëndësishme për

të, por pak e vlefshme për shqiptarët, është se nga Luksemburgu iu bënë disa dhurata që t'i shpëtonin fytyrën. Iu fal termi "hapje negociatash" dhe një datë efemere që askush se di se kur kanë për të ndodhur. Ajo që dihet me siguri është mënyra se përse do t'i përdorë ai këto.

Lapsi.al

Po, Edi Rama dhe taborët e tij kanë një lloj të drejte të ndihën të lehtësuar. Ata arritën të shpëtojnë fytyrën dhe të shmangin turpërimin, sepse rezultati para mbledhjes të Këshillit të marrëdhënive të Përgjithshme të Luksemburgut mund të ishte edhe më i keq. Deri pak ditë më parë, në tryezë ndodhej varianti që Shqipërisë t'i thuhej një "Jo" e plotë. Pas votimit negativ të parlamentit holandez, këmbënguljes mohuese të Francës dhe intransigjencës së Danimarkës, Shqipëria jo vetëm rrezikohet të mbetet në klasë, por ajo kanosej edhe nga skenari më i errët i mundshëm, ndarja e fatit të saj nga Maqedonia. Në tryezat e Brukselit, deri në mbarim të javës që shkoi, qarkullonte edhe një version, që fqinjët tonë sllav t'i hapet drita jeshile, ndërsa në të refuzoheshim për të tretën herë radhazi

HOROSKOPI

DASHI

Do t'ju duhet të përballeni me ndonjë të papritur dhe nuk do të keni atë elasticitet që do të ishte i nevojshëm për t'u përballur me risi dhe për të riorganizuar programin. Kjo mënyrë e vazhdueshme për të pyetur të tjerët ndoshta fshih paafësinë për pranuar atë çka është e ndryshme nga ju.

DEMI

Në ndikimin e Uranit dhe Venusit priten perspektiva interesante rishish në sektorin e dashurisë, mbi të gjitha nëse jeni beqarë. Do të rrethoheni nga njerëz me të cilët ndihen mirë dhe do të mënjanoi ata që duan t'u detyrojnë zgjedhjet edhe mendimet e tyre.

BINJAKET

Do të kaloni disa zënka dhe do t'ia diini të tejkaloni të gjitha pengesat që ju ndalojnë të merreni vesh me partnerin e dashur. Mos i lini pas dore çështjet private për të dëgjuar dhe për të ndihmuar një person që ju kërkon ndihmë.

GAFORJA

Me Neptunin që ju mbron, mund të mbështeteni tek miqësi dhe kontakte konstruktive. Jini të sigurt që jeta e juaj është duke evoluar në drejtime më interesante. Me Marsin armiqësor, kini kujdes nga gabimet në vlerësimin e sjelljeve për të mos gabuar.

LUANI

Ndonjë zënkë më shumë dhe klima dashurore do të ndikohet ndjeshëm. Do të jetë më mirë t'i kontrolloni reagimet e gjaknxehtësisë. Një mik, vëm t'ju mohuar mbështetjen e premtuar, do të përpiqet t'ju fusë dyshime për zgjedhjen e bërë.

VIRGJERESHA

Venusi, Marsi dhe Neptuni bashkëveprojnë me Hënën në favorin e juaj. Do të njihni persona, të cilët mund t'ua vërtetojnë menjëherë vlerën dhe sinqeritetin. Po kaloni një periudhë ndryshimesh në çdo fushë. Të papriturat do t'ju bëjnë përsëri vizitë.

PESHORJA

Do të keni fërkime me një familjar që këmbëngul se gjithçka shkon mirë, ndërsa në realitet ka tensione të fsheshura. Kush jeton në çift, duhet të bëjë kujdes që të mos ndërlikojë atë që është e thjeshtë dhe e drejtëpërdrejtë.

AKREPI

Me favorizimin e Jupiterit, nëse jeni në kërkim të një pune, dijeni se fati mund t'ju trokasë në derë. Mos rini duarkryq, sot mund të hapni një kapitull të ri në lidhjet dashurore.

SHIGJETARI

Mirëkuptimi i personave që ju qëndrojnë në krah do ta ketë të vështirë të qëndrojnë nervozizimin tuaj. Do të jetë e vështirë të ruash qetësinë ndaj atyre që vazhdojnë të bëjnë po të njëjta propozime shumë herë.

BRICJAPI

Me planetin e dashurisë që ju mbron, do të kërkoni mundësi dialogu dhe bashkëpunimi me personin e zemrës. Lidhja do të rezultojë më e forcur. Nuk duhet të sforcoheni shumë për të qëndruar në formë.

UJORI

Plutoni jo shumë miqësor do t'ju kujtojë se duhet të ndërtoni marrëdhënie të karakterizuara nga ekuilibri i duhur midis rastezës dhe vetëkontrollit. Vazhdoni të hani në mënyrë të shëndetshme, duke zgjedhur me saktësi ushqime të cilësishë së mirë.

PESHQI

Hëna rrit optimizmin dhe aftësinë komunikuese. Vërtet do të jeni pak egocentrikë, por edhe të shkëlqyer dhe interesant si kur më parë. E dini faktin tuaj, por do të arrini edhe të përfiton nga rasti për të mësuar nga persona vërtet të veçantë.

Andan Januzaj ka qenë protagonist i ndeshjes së sotme mes Belgjikës dhe Anglisë, duke shënuar golin e fitores 1-0 të përfaqësueses së tij ndaj skuadrës britanike. Por ky gol dhe kjo fitore i ka kushtuar rëndë belgëve, që e kanë parë veten të ngjiten në vendin e parë në klasifikimin e grupit dhe të kalojnë në krahun e "vështirë" të skemës që të çon drejt finales së Botërorit. Fituesi i vërtetë



Goli i shqiptarit mposhti Anglinë

Januzaj fluturon Belgjikën në krye të grupit

i kësaj ndeshje, faktikisht mund të quhet se është vetë humbësi, pasi kryesuesi i këtij grupi duhet të shkojë në "fer", duke pasur si kundërshtarë të mundshëm Brazilin, Argjentinën, Portugalinë dhe

Francën. Për këtë arsye vendi i dytë i marrë nga Anglia, mund të konsiderohet si një triumf më vete.

Panamaja dhe Tunizia ishin të dyja të skualifikuara që pas takimeve të dyta në grup,

por në përballjen e tyre luajn për tifozyt dhe me dëshirën për të mos e mbyllur aventurën e tyre në grupet e botërorit pa pikë. Si për ironi të fatit, golin e parë të takimit e shënojnë po tuniz-

ianët, por në portën e tyre, duke i dhënë avantazhin Panamasë pas autogolit të Meriah, por Tunizia do të shpërthejë në pjesën e dytë. Fillimisht afrikano-veriorët barazojnë me anë të Ben Jusef, ndërsa Khazrin shënon golin e dytë. Rezultati nuk do të ndryshojë deri në fund. Tunizia merr fitoren e vetme në grup, ndërsa dëshira e Panamasë për të marrë pikën historike, mbeti një tentativë.



Jeton Selimi

Senegali dhe Japonia kishin gjithçka të barabartë, përveç kartonëve të verdhë, me afrikanët më të ndëshkuar

E pabesueshme, kartonët skualifikojnë Senegalin!

Kolumbia e mbyll në krye të grupit me 6 pikë

Kolumbia feston, Senegali dëshpërohet. Ver diktet e dy ndeshjeve të fundit të grupit H janë jashtë Kupës së Botës përfaqësuesen afrikane, e cila nuk arriti të kalojë më të pavarësisht 4 pikëve të marra. Kjo për shkak të një rregulli të ri që u aplikua në Rusi 2018 dhe që regjistroi një nga episodet më të çuditshme në futboll. Senegali u eliminua prej dy kartonëve të verdhë më shumë të grumbulluar gjatë 3 ndeshjeve sesa Japonia. Të dyja skuadrat e mbyllën grupin me 4 pikë, kishin shënuar dhe pësuar nga 4 gola, madje dhe në takimin direkt kishin barazuar 2-2. Për të vënë drejtësi, hyri menjëherë rregulli i Fair Play, ai i kartonëve të verdhë të marrë në një ndeshje apo në tjetrën. Pranë fundit të ndeshjes, Japonia kishte vetëm 4 lojtarë që kishin marrë të verdhë gjatë aktivitetit ndërsa Senegali kishte 6 futbollistë të ndëshkuar me të verdhë, ndërsa në takimet e fundit si Japonia ashtu edhe Senegali u ndëshkuan edhe me nga një tjetër karton të verdhë, ndërsa ata që e pësuan ishin afrikanët. Natyrisht që ky episod i rrallë, që vlen të veçohet e të trajtohet më vete. Sa i takon sfidës, Kolumbia ishte më pranë fitores sesa Sene-



gali, ndërsa avantazhin e arritën në minutën e 74-ër pas goditjes së saktë me kokë nga ana e Minas. Për t'u theksuar edhe episodi i minutës së 17-të kur serbi Mazić akordoi fillimisht një penallti, ndërsa pasi u konsultua me VAR-in, e ktheu vendimin mbrapsht. Senegali u përpoq shumë në minutat e fundit të ndeshjes

të barazonte dhe të siguronte kualifikimin, por nuk ia doli. Kolumbia arriti të merrte vendin e parë në grup, ndonëse e nisi keq fushatën e botërorit pas humbjes me Japoninë, por dy fitoret radhazi me Poloninë dhe me Senegalin e katapultuan si forcë e parë në grupin H.

JAPONIA BUZËQESH

Japonia humbet, por është nga ato humbjet që nuk dhem, madje të bën të vësh buzën në gaz. Dakord, mierzia e humbjes qëndron, por nëse kjo humbje nuk të dëmton ëndrrën e kalimit të grupit, atëherë je në rregull. Kjo u ndodhi dhe të besuarve të Akira Nishinos, që ndaj Polonisë së eliminuar u mjaftonte

vetëm një barazim për të qëndruar të qetë. Por në "Volgograd Arena" djemtë që vimin nga toka ku lind dielli rrezikuan shumë. Sfidat në përgjithësi ishte e varfër me raste, sidomos pjesa e parë ndërsa ata që kërcënuan më shumë ishin polakët e Adam Navalkës. 45 minutat e para do të mbyllën me rrjeta të pa-

prekura, ndërsa në pjesën e dytë, polakët kërkojnë fitoren për të shënuar sado pak shpirtin e lënduar nga një kualifikim mbase i pamenduar. Në minutën e 59-të Jan Bednarek çel rezultati. Kurzava harkon nga këndorja dhe Bednarek gjuan fort me të djathtë duke kaluar në avantazh Poloninë. Bardhekuqtë vijojnë të këmbëngulin në kuadratin e Kavashimës, ndërsa Levandovski do të shkojë shumë pranë realizimit të golit të parë në këtë Kupë Bote, por çuditërisht do të shpërdorojë në mënyrë të pabesueshme asitën e Grosiçkit. Japonia duket e dorëzuar dhe më shumë sesa të sulmojë, e ka mendjen të ruhet nga goli i dytë dhe kartonët e verdhë. Gjithsesi, asgjë nuk do të ndryshojë deri në fund. Polonia do të arrijë fitoren e parë në grupin H, ndërsa aziatikët arrijnë të kalojnë më tej për në fazën e 1/8-ave.

BOTERORI RUSI 2018					
Grupi H			Grupi H		
Angli - Belgjikë	0-1		Senegal - Kolumbia	0-1	
Tunizi - Panama	2-1		Japoni - Poloni	0-1	
Renditja			Renditja		
Skuadra	N	F	Skuadra	N	F
Belgjika	3	9	Kolumbia	3	6
Anglia	3	6	Japoni	3	4
Tunizia	3	3	Senegal	3	4
Panamaja	3	0	Poloni	3	3

Nga Nojeri, te senatorët, por edhe Lëv që la jashtë Sanen

Ja arsyet e dështimit të Gjermanisë

Eliminimi i turpshëm xhiron e botës, mbi të gjitha për mënyrën se si erdhi, një eliminim jashtë çdo logjike i ardhur përballë një kundërshtari si Korea e Jugut, e fundit që zyrtarizoi një botëror të nisur dhe i mbyllur me turp. Mund të quhet mallkimi i grupit F, apo mallkimi i kampjonat në fuqi, por ajo që u pa në fushën e lojës ishte shumë e dukshme, një makineri, e

cila nuk funksioni në asnjë repart.

E nisim nga porta

Dalja e Nojerit në sulm rezultoi fatale me Korenë që shënoi golin e dytë, mbase ky është një detaj i pa rëndësishëm në një ndeshje, e cila dukej se nuk kishte më kthim pas, por pyetja që shtrihet është pse Nojer duhet të ishte titullar pasi një sezoni në infermieri në një kohë kur Ter Shtegen kish të zhvilluar një vit fantastik me Barcelonën.

Mbrojtje e

brishtë me Boateng-Humels

Vetëm Egjipti dhe Korea e Jugut kanë pësuar më shumë gjuajtje në kuadrat. Të qëndërmbrojtësit ishin shumë të ngadalë në vepërimet e tyre, koordinoheshin me shumë vështirësi dhe ishin të prekshëm në çdo sulm të kundërshtarëve dhe të mendosh çfarë ekipet kishte Gjermania në grupin F.

Varësia nga Kimish

Mbrojtësi i Bajern ishte lojtari më me shumë asist në

kualifikuese, e gjithë loja e Gjermanisë ishte e përqendruar në krahun e djathtë, dhe kjo ishte shumë e lexueshme. Daljet e tij të vazhdueshme në sulm lanë shumë hapësira pas, diçka të cilën kundërshtarët e shfrytëzuan në maksimum.

Toni Kros i vetmuar

Gjermania ka mbase në formacion një nga mesfushorët më të mirë në Botë si Toni Kros, por gjatë tre ndeshjeve në fazën e grupeve, ylli i Real Madrid, ishte i

vetëm mesfushë në pjesën më të madhe të kohës, ose i shoqëruar nga dy qëndërmbrojtësit, kjo e bënte shumë të lexueshme daljen e Gjermanisë përpara duke i dhënë kohë kundërshtarit të pozicionohet.

Mungesa e Sane

Lojtari më i mirë i ri në Premier League nuk u preferua nga Lëv, në një skuadër pa freski dhe pa ide, prezenca e tij do të ishte thelbësore.

Mungesa e një pike referimi në sulm

Çdo tifoz i gjerman pas çdo minutë që kalonte i shkante ndërmend Miro Klose. Timo Verner dhe pse vinte në këtë botëror si gundëshuesi më i mirë i Bundesligës, nuk arriti të linte gjurmë në Rusi 2018, shpesh dukej sikur nuk e kishte kuptuar se çfarë

roli kishte në këtë Botëror.


Forma fizike

E gjithë skuadra e Gjermanisë kishte një problem të përbashkët, gjendje fizike shumë e rënduar. Praktikisht gjermania u largua nga ky Botëror duke ecur e jo duke vrapuar.

Trajneri dhe senatorët

Problemi i fundit, por jo më pak i rëndësishëm ishte trajneri Jokakim Lëv. I qëndroi besnik titullarëve në Brazil 2014, edhe kur vendosi të linte në stol, lojtari si Ozil Gedira etj, ndryshojë sërish mendim dhe i riaktivizojë në sfidën e fundit, pikërisht senatorët ishin ata që dështuan më shumë, shkurt një trajner pa ide që ishte në sinkron më pjesën tjetër të ekipit, e mbyll me turp dhe shumë pranë shkarkimit.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Ishite dekret i sulltanit.
8. Fillojnë nazet.
9. Eshhtë bosht.
10. Eshhtë studio e Barack Obama-s.
13. Fillojnë romanin.
14. Pak nepozitëm.
17. Mbahen për të ndaluar.
18. Janë njerëz me dy faqe.
21. U mbiquajt Princi i oratorëve.
22. Nofka e Eisenhoëer.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Rodrigues, që u quajt mbretëresha e fado-s.
27. Kush është... nuk është i lirë.
29. Bën be pa u betuar një e tillë.
30. Kështu mbyllet dera.
33. Eshhtë për medaljen e parë

VERTIKAL

1. Eli këngëtare.
2. Pak ekologjike.
3. Rastis në kufij.
4. Janë tempereturat më të ulëta.
5. Inicialet e Lendl.
6. Jetojnë në kryeqendrën piemonteze.
7. Campion regjisor.
8. Gabim rrjete në tenis.
11. Janë si cilësi.
12. Ishite gjuha e romakëve.
15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. I vihet kalit.
18. Rrapo i luftëtarëve.
19. Aktet pa kufij.
20. Mbyllet me dorezë.
21. Eshhtë periudha e ftohtë.
23. Në krye të komandës.
24. Një artist si Tristan Tzara.
28. Janë sportistët që bëjnë stil të lirë.
31. Hapin pa kufij.
32. Oethen me qen.
35. Një mendim.
36. Kusturica, regjisor.
37. Parajsa e humbur.
39. Një stacion i famshëm orbital.
40. Pak aromatike.
43. Pak interesante.
46. Lirë në qendër.
48. Nota e diapazonit.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Bunuel regjisor.
4. Të parat në sport.
6. Rodrigues që këndonte fado.
11. I famshmi Pacino.
12. Kujdeset në... ekstreme.
14. Eshhtë skllavëri.
16. Eshhtë shtypi jo përditshëm.
18. Janë tek në banka.
20. Eshhtë ndeshje e... fundit.
21. Lumi i Bernës.
23. Janë me numër ato ushtarake.
24. Nesti pa pa çifte.
25. Si gjithë.
26. Sipërfaqe e shkurtër.
27. Ato të peshkut janë pa vlerë
28. Janë marifete... me grim.
31. Ethet e tij zunë kërkuesit.

VERTIKAL


32. Skuadra merengue.
33. Eshhtë trofet që fitohet.
34. Ndahen nga ortakët.
36. Një biçikletë dyshë.
39. Qetësonte detin.
42. Kanë dhoma që zihen.
44. Eshhtë ekulibri në palestër.
46. Në krye të jurisë.
47. Numri i kuartetit.
48. Gjysmë armate.
7. Portokalli i Stanley Kubrick.
8. Në krye të artistëve.
9. Eshhtë edhe ai i rekordeve.
10. Fleming që krijoi James Bond.
13. Janë binarë.
15. Janë dhoma.
16. Eshhtë i zi... pikant.
17. Institucione Lokale Tiranë.
19. Pagëzoi Shën Palin.
20. Eshhtë besimi i besimtarëve.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për... gol.
27. Një fjalë për më vonë.
29. Maria Rilke, shkrimtar.
30. Fillojnë turmin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
34. Eshhtë copë... torte.
35. Mbyllin një tender.
34. Ndo në kufij.
38. Një pëlhurë.
40. Lidh dy brigjet.
41. Një pije piratësh.
43. Fillojnë lehtë.
45. Të fundit në sirtar.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

	4				
2	3		1		4
	9	6	2		7
8			6		4
		9	1	7	5
			5	6	3
3	8			9	
		5	7	3	
2			4		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	4	5	3	1	2	9	6	7
7	2	6	8	4	9	1	3	5
9	1	3	5	7	6	8	2	4
2	3	4	6	5	8	7	9	1
5	6	7	1	9	3	2	4	8
1	8	9	4	2	7	3	5	6
6	5	8	9	3	1	4	7	2
3	7	1	2	6	4	5	8	9
4	9	2	7	8	5	6	1	3

Argëtim filozofik

- Dembelizmi ecën aq ngadalë saqë varfëria e arrin menjëherë.

- Nëse prindërit punojnë dhe fëmijët e tyre i'a kalojnë mirë, atëherë nipërit e tyre sigurisht do të përfundojnë lypsarë.

- Isha kaq i varfër kur isha fëmijë ... Po të mos isha djalë, nuk do të kisha asgjë për të luajtur ...



KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

8	A	1	11	16	7	5	15	8	3	8	M	I	K	E	K	M	S	E				
1	Z	9	13	9	6	6	9	6	3	8	12	E	K	A	R	O	M	A	K	E	T	
2	I	7	10	8	9	2	15	2	11	3	2	K	M	I	L	I	T	A	N	T	E	T
9	L	14	8	12	17	12	3	7	9	9	2	K	M	A	T	E	M	A	T	I	K	A
5	7	15	5	8	5	2	16	8	5	16	P	A	S	A	N	I	K	T	S			
4	8	6	5	2	15	8	7	15	10	7	E	K	U	A	N	E	T	A	R	E	T	
7	5	7	12	7	15	6	11	6	8	15	R	E	T	E	E	I	R	A	N	I		
5	6	4	7	5	2	18	2	11	19	7	I	T	R	B	L	A	K	E	L			
5	4	11	6	19	9	8	8	4	8	6	M	I	A	R	E	D	E	K	I			
9	11	15	1	7	5	8	19	8	1	8	E	M	E	T	A	L	E	I	S			
7	6	2	14	14	7	16	11	15	7	T	E	K	E	M	K	U	M	T				
5	7	8	4	8	9	3	8	15	7	5	M	O	R	A	V	I	A	M	A	E		

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

AR KA A A S T R O A M A
D T A N A H A N T I K
A T L A N T I K E O L S
P E I T A R I F A T L E
T T P O L I T I K A N E T
K E N E T A O R A R
P A U L I N R E R I
A K E O T A D D I M
R E U N E K I E R A
E T I T T E R I A M A N
T E I T G O R D I A N E
I N T A R O M A T I T

PA B M E L E R G O
R K U P A E M I R A T E
O H A R A D A R O M A T
C I K L I S T E T
S T A D I U M E T A P E L
D I K A S T E R E R U V
K E N T N G O P J E V
K A T I A S I E E S E
A R N I O L A I R
M A S S I M O Z A N O R E
A M A N A N N A N N
T T E R R E N I E I N E

Ehënie të mençura

- Të pamposhturit janë ata që tregohen të
- fortë, kur sulmohen në pikat e dobëta
- - Më pëlqente. Dukej një tip interesant
- derisa filloi të flasë... Cfarë mallkimi!
- - Të shtiresha i geuzar kur je i merzitur,eshte
- njesoj sikur te dalesh ne shi dhe te thuash
- nuk jam lagur...
- - Rrim duke pritur dhe shpresojm te na
- shfaqet rruga e duhur,dhe harroj m se rruga
- e duhur gjindet duke ecur dhe jo duke

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

